Problemi kryesorë për mësuesit është se si ti mbajnë të përfshirë nxënësit gjatë gjithë mësimit, për tu realizuar në mënyrë të suksesshme objektivat e parashikuara.

Në çdo kohë mësuesi ka kërkesa të ndryshme e bashkëveprime të shumta që e shtyejnë përpara për veprim.

Është e rëndësishme të theksojmë se menaxhimi i klasës fillon me zhvillimin e ndërtimit të besimit dhe marrëdhënieve midis nxënësve. Pa ndjenjat e respektit dhe besimit të ndërsjelltë mësuesi e ka të vështirë ta kryej rolin e tij në klasë. (Bardhyl, 2003).

Fjala menaxhim do të thotë udhëheqje, drejtim, organizim, në këtë kontest, në kuadër të procesit mësimor. Trajtimi teorik mbi menaxhimin e klasës dhe reflektimi rreth metodologjisë efektive për zbatimin praktik në klasë, janë dispozitat themelore me të cilat mund të realizohet mësimdhënia e suksesshme.

Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimeve të tilla të cilat duke synuar që të bëhet përfshirja produktive e nxënësve në mësim.

Për të menaxhuar me sukses një klasë kërkohet prej mësimitdhënësit të planifikoj mirë çdo aktivitetet që ndërlidhet me kohën, me qëllimet, me objektivat, me aktivitetet, me materialet që do ti përdorë ku ai duhet të jetë sa më atraktiv për nxënësit, duhet të jetë vigjilent që duke i përcjell vazhdimisht se a janë të përfshirë gjithë nxënësit në procesin e të nxënës, tua ndaj detyrat duke i mbështetur ata që kanë nevojë dhe të kontribuoj në mënyrë të suksesshme në realizimin e objektivave të parashikuara.

Menaxhimi i mirë i klasës është një përbërës kryesor i suksesit të klasës, i mësimitdhënësit dhe i të nxënës. Për të përmbushur këto qëllime, kërkohet që mësimitdhënësit të vendosin një atmosferë të mirë pune dhe të krijoj një klimë pozitive dhe frymë bashkëpunuese në klasë. Menaxhimi është mënyra se si organizohet klasa dhe si ai organizim ndikon në të gjithë klimën e klasës dhe në sjelljen e nxënësve dhe në suksesin e tyre në përgjithësi.

Në kuadër të metodave aktive roli i mësimitdhënësit është si inspirues dhe krijues i situatave në të cilat nxënësi ballafaqohet me problemet, ku sipas tij nxënësi është një mendimtar spontan dhe individual.

Krahas përzgjedhjes së metodave dhe përgatitjes profesionale të mësimitdhënësit, rol të madh ka edhe menaxhimi i situatave të padëshirueshme në klasë, menaxhimi i kohës, menaxhimi i sjelljeve, menaxhimi i procesit mësimor, menaxhimi i konflikteve, menaxhimi i disiplinës, motivimi i nxënësve, respektimi i rregullave të klasës etj.

Udhëheqja e mirë dhe e ekuilibruar ka rëndësi për një shkollë të suksesshme, sepse kjo reflekton drejtpërdrejt dhe mbi të gjitha në suksesin e përgjithshëm të nxënësve dhe në arritjet dhe rezultatet e kënaqshme të tyre.

Andaj kësaj çështjeje i kushtohet rëndësi e dorës së parë, sepse nga mënyra e udhëheqjes së një institucioni, respektivisht të një shkolle varet tërë puna dhe rezultatet e përgjithshme në mësim.

Prandaj edhe në teorinë pedagogjike i kushtohet rëndësi e veçantë kësaj çështjeje, duke i

shqyrtuar të gjithë parametrat, kërkesat dhe vlerat që duhet t'i ketë drejtori i një institucioni shkollor, por edhe organet e tjera drejtuese të saj.³

³ ipkmasht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2015/11/Shkaqet-e-humbjes-se-interesimit-te-nxenesve-permesim.pdf

1.1 Strategjitë e menaxhimit të klasave

Mësues të suksesshëm janë ata të cilët e kanë sjellë klasën e vet në gjendje ku mund të thonë: “Nxënësit do të vazhdojnë t’i punojnë detyrat e dhëna, pa dallim a jam ose s’jam unë me ata.” (Marija Montessori)

Menaxhimi është një proces operacional që fillon me një shqyrtim të situatës duke analizuar funksionet e menaxhimit. Pesë funksionet themelore të menaxhimit janë: planifikimi, organizimi, drejtimi, rekrutimi dhe kontrolli.

Menaxhimi i klasës – ka të bëjë me menaxhimin e mësimit dhe organizimin e veprimtarive të atilla të të nxënësve duke synuar të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim.

Menaxhimi i suksesshëm i mësimit kërkon prej mësuesit të jetë vazhdimisht i vëmendshëm dhe në veprim, për të siguruar se nxënësit mësojnë normalisht.

Menaxhimi i klasës nuk është gjë tjetër veçse zbatimi dhe përdorimi i të gjitha rregullave dhe procedurave për sigurimin e rregullit, disiplinës dhe mbarëvajtjes së mësimit në klasë ⁴

Menaxhimi i klasës përbëhet kryesisht nga aspekti fizik dhe social i tij dhe është përgjegjësi e mësuesit dhe e nxënësve për ta siguruar dhe për ta mbrojtur në mënyrë që ai të jetë sa më efektiv për zhvillimin me sukses të mësimit.

Që menaxhimi të jetë sa më i efektshëm, duhet të zbatohen disa teknika të tij.⁵

Këto teknika të menaxhimit të klasës fillojnë duke filluar që në fillim të shkollës:

Fillimisht mësuesi tregon se është i përgatitur për një punë të gjatë që e pret përpara dhe se ka besim tek vetja për të realizuar që në ditën e parë të shkollës po ashtu mësuesi i mirë fillon mësimin në ditën e parë të shkollës me një detyrë, e cila është shumë e qartë dhe mund të kryhet në mënyrë të suksesshme nga nxënësit.

⁴ Bardhyl Musai, Metodologji e mësimdhënies, fq. 65

⁵ Bardhyl Musai, Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies, fq. 53

Për të pasur menaxhim të suksesshëm mësuesi demonstroi në mënyrë të vazhdueshme se është kompetent, i përgatitur mirë dhe se është në krye të punës, ai po ashtu duhet të jetë profesionist, i këndshëm dhe të përpiqet që të krijojë një atmosferë miqësore me nxënësit në klasë.

Ai duhet të tregojë se është në koherencë me gjithçka që ndodh në klasë, kjo bën që këta mësues të kenë më pak probleme në klasë, duke i krahasuar me ata mësues që nuk janë në dijeni të asaj që ndodh në klasë. Menaxhuesi i klasës duhet të jetë i aftë për t'u marrë me shumë gjëra në të njëjtën kohë duke ruajtur ritmin e duhur të veprimtarive në klasë.

Mësuesi duhet të bëjë një analizë të punës së tij duke reflektuar se si e ka menaxhuar klasën. Mësuesi duhet të përpiqet të përfshijë në mësim të gjithë nxënësit dhe në rastet kur shihet se në orën e mësimit nuk shkon diçka, mësuesi duhet të përpiqet të ndryshojë materialin që është duke dhënë, duke e bërë atë më të lehtë dhe më të kuptueshëm për nxënësit.⁶

Disa aspekte tjera kyçe të menaxhimit të klasës janë:

Mësime të planifikuara mirë dhe interesante; Zhvillimi i marrëdhënieve pozitive në klasë;

Motivimi i nxënësve për të nxënë; Rregullat e klasës; Disiplinë pozitive në klasë;

Aftësi komunikuese të mira të mësuesit dhe nxënësve.⁷

Menaxhimi i klasës ka lidhje të ngushtë me sjelljen e mësuesit. Për këtë mësuesi duhet të jetë i drejtë me nxënësit, të zotërojë mirë lëndën, të kontrollojë emocionet e tij, të ndihmojë nxënësit në rast nevojë, të ndjekë ecurinë e nxënësve gjatë kryerjes së detyrave etj.

Nga përvoja e vëzhgimeve, mund të themi se mësuesi ynë, jo rrallë humbet shumë kohë në orën e mësimit, humbje e cila ndodh jo vetëm si rrjedhojë e abuzive, por mbi të gjitha nga aftësitë e kufizuara menaxhuese të klasës.

⁶ Majkëll Fullan, fq. 143

⁷ Po aty, fq. 145

1.1.2 Kuptimi mbi menaxhimin e klasës

Së pari fillojmë me konceptin e fjalës menaxhim: Të menaxhosh është të parashikosh dhe të planifikosh ,të organizosh ,të koordinosh dhe të kontrollosh .(Henri Fayol) .

Pas identifikimit të problemit të hulumtimit kam filluar me hulumtimin e literaturës.

Menaxhim do të thotë bërja e punëve nëpërmjet resurseve në dispozicion si njerëzve, mjeteve financiare ,objekteve.⁸

Menaxhimi i klasës është një temë shumë e gjerë dhe interesante për tu studiuar. Menaxhimi është mënyra se si organizohet klasa si dhe a ndikon në të gjithë klimën e klasës dhe sjelljen e nxënësve.

Ky trajtim teorik në këtë punim, përfshinë kriteret më themelore që ndërlidhen me menaxhimin e klasës, attribute këto të cilat duhet t'i posedojë dhe zbatojë çdo mësues në shkollën e sotme.

Studimi i tillë ka të bëjë me drejtimin e klasës, formimin e grupeve, fillimin dhe përfundimin e mësimit, ekologjinë e klasave, klimën e klasës, motivimin e nxënësve, vetitë e mësuesit, komunikimi me nxënësit, mbajtja e disiplinës në klasë.

Çfarë është menaxhimi i klasës?

Unë kam arritur në një përfundim plotësisht të qartë, se mësuesi është faktori vendimtar në klasë. Është mënyra personale e të sjellurit që krijon gjithë klimën në klasë.

Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të nxënësit duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim. Fjala menaxhim do të thotë udhëheqje, drejtim, organizim, në këtë kontekst, në kuadër të procesit mësimor. Mësuesi duhet të jetë profesionistë i këndshëm dhe të përpiqet që të krijoj një atmosferë miqësore me nxënësit në klasë. Mësuesi duhet të përpiqet të përfshijë në mësim të gjithë nxënësit edhe atëherë kur ai punon me një nxënë të veçantë. Mësuesi duhet të jetë i aftë për t'u marrë me shumë gjera në të njëjtën kohë. Duhet ruajtur ritmi i duhur i veprimtarive në klasë. Mësuesi duhet të pakësojë përdorimin e metodave ndëshkuese dhe të shtoj përforsimet.

⁸ https://youtu.be/_OBqëhYLEJo

Të përdorë saktësisht procedurat e menaxhimit të sjelljes duke përforcuar sjelljet pozitive duke përcaktuar rregulla të qarta për sjelljen e nxënësve në klasë.

1.2 Karakteristikat e klasave I-V në komunën e Mitrovicës

Klasa e përbërë nga nxënësit formon një grup në tërësinë e vet, ku çdo grup në formimin e tij kalon nëpër disa faza të zhvillimit ku përcaktohet nga menaxhimi i efektshëm dhe produktiv i mësuesit, në përmbushjen e qëllimeve të nxënësve në klasë.

Klasat janë lloje të veçanta të mjediseve. Zakonisht në komunën e Mitrovicës kemi klasa të cilat kanë numër të madh të nxënësve .Po ashtu kemi edhe klasa të bashkangjitura për fëmijët me nevoja të veçanta.

1. Klasat janë të shumë përmasave. Ato janë plot me njerëz, detyra nën presionin e kohës.Shumë individ të gjithë sipas synimeve,parapëlqimeve dhe aftësive të ndryshme.

2. Karakteristikë tjetër që është njëkohshmëria. Gjithçka ndodh njëherazi,kur Mësimdhënësi shpjegon një koncept, ai duhet, gjithashtu, të këtë kujdes nëse nxënësit po e ndjekin apo jo shpjegimin.

3. Karakteristikë tjetër, menjëhershëmëria, ka të bëjë me ritmin e shpejtë të jetës së

klasës. Mësimdhënësi, në një ditë të vetme ka qindra shkëmbime me nxënësit.

4. Në këtë ekzistencë të gjallë, ngjarjet janë mjaft të parashikueshme, edhe kur planet janë bërë me kujdes kur mjeti është në vendin e duhur dhe gjithçka është gati,mësimi mund të

ndërpritet nga një defekt i papritur i një mjeti me anë të cilit po kryhet eksperimenti,matja

etj ndonjë nxënës mund të sëmuret papritur.

5. Mënyra se si i trajton mësimdhënësi këto ndërhyrje të papritura shikohet nga të gjithë, sepse klasat janë publike, nxënësit gjithmonë mundohen të vënë re se sa „i zoti është Mësimdhënësi”.

6. Klasat e kanë historinë e tyre, domethënia e veprimit të veçantë të mësimdhënësit apo nxënësit varet pjesërisht nga çka ka ndodhur më parë. Kur nxënësi hyn me vonesë për të

disatën herë,atëherë mësimdhënësi mund të reagojë ndryshe nga hera e fundit.⁹

Secila klasë karakterizohet me:

Orar kohor të përgatitur mirë ,strukturë të mirë organizuese,ambient të këndshëm

klimë pozitive pune ,materiale didaktike dhe të shpenzueshme¹⁰

Dimensione të rëndësishme pedagogjike për klasën e shekullit XXI janë:

Sipas kërkesave të shoqërisë e cila duhet ti përballoj sfidat e këtij shekulli, klasa duhet të përmbush disa kushte në mënyrë që të jap rezultate pozitive duke përgatitur nxënësit për kohën në të cilën po jetojmë .

Klasa e shekullit XXI duhet të paraqitet si mjedis i organizuar mirë për të nxënësit,ku duhet të përdoren teknika të cilat e zhvillojnë të menduarit kritik, duke përdorur materiale të ndryshme që zhvillojnë imagjinatën ,motivojnë nxënësit ,po ashtu duhet vazhdimisht të planifikohet procesi mësimor dhe të bëhet vlerësim sistematik i përparimit apo ngecjes në mësim,si dhe të të përfshihen prindërit në vendimmarrje në shkollë duke u forcuar bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin. Gjitha këto arrihen duke zbatuar kompetencat tona që i kemi si mësimdhënës përndryshe pa një bashkëpunim me familjen dhe me kolegët rezultatit nuk do të jetë i kënaqshëm.¹¹

1.2.1 Klasa tradicionale

Sipas mendimit tim nëse bëjmë një krahasim të klasave tradicionale me klasat e shekullit XXI atëherë po veçoj se në klasat tradicionale programi mësimor është prezantuar nëpër përmbajtje të zgjedhura mësimore dhe është përcaktuar e zhvilluar nga ekspertët e jashtëm.

Përmbajtja mësimore është dizajnuar në përkrahje të pritjeve tradicionale të lidhura me

sjelljen sociale dhe arritjet akademike kurse kultura dhe dallimet e tjera individuale janë të injoruar dhe prej fëmijëve pritej që të adaptohen sipas kulturës dominuese që do të thotë se ka pasur diskriminime dhe gjitha aktivitetet janë bazuar mbi librin nuk ka pasur aktivitete që zhvillojnë,

⁹ Musai Bardhyl, Psikologji edukimit, Tiranë 1999, fq. 227

¹⁰ Suzana Kiranxhiska, Tatjana Llazarevski, Gjorgjieva), - Shkup:

¹¹ Burke,Walsh,Kate,Krijimi I mjedisit për të nxënësit për shekullin XXI,Shkup,fq17

shkathtësi të ndryshme ku theksi është vënë vetëm mbi zotërimin e aftësive themelore. Po ashtu në klasën tradicionale mësimdhënësi ka qenë në qendër e jo nxënësi.

Sa i përket vlerësimit të nxënësve nuk ka ekzistuar vlerësimi formativ por vetëm vlerësimi përfundimtar. Nxënësit kanë punuar ma tepër në mënyrë individuale jo në grupe.

1.2.2 Klasa e shekullit XXI

Unë mendoj se sa i përket klasës së shekullit XXI ajo ka dallim shumë të madh nga klasa tradicionale sepse përmbajtja mësimore është e integruar dhe fëmijët punojnë në grupe duke bashkëpunuar. Po ashtu përmbajtja mësimore nuk varet vetëm nga ekspertët e jashtëm por varet nga dëshirat dhe interesat e fëmijëve ku vendimet merren në mënyrë të përbashkët me nxënësit.

Programi mësimor është krijuar ashtu që u përshtatet potencialeve individuale të fëmijëve edhe krijon marrëdhënie pozitive kah të nxënit duke krijuar mundësi për gjithpërfshirje dhe mosdiskriminim ku respektohen diversiteti kulturor me qëllim që të përgatiten nxënësit më të mirë për të ardhmen . Nxënësi është në qendër e jo mësimdhënësi, ku aktivitetet bazohen mbi burime të ndryshme informatash që përdoren jo vetëm libri por edhe interneti, revistat dhe theksi vihet mbi kuptimin e koncepteve të rëndësishme.

Mësimi zhvillohet në frymën e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet nxënësve.

1.3 Katër stadet e menaxhimit

Klasa e përbërë nga nxënësit formon një grup në tërësinë e vet, ku çdo grup në formimin e tij kalon nëpër disa faza të zhvillimit ku përcaktohet nga menaxhimi i efektshëm dhe produktiv i mësuesit, në përmbushjen e qëllimeve të nxënësve në klasë.

1. Formimi – zgjidhja e shqetësimeve rreth pranimin dhe marrjes së përgjegjësisë.
2. Shpërthimi- zgjidhje e shqetësimeve rreth ndikimit të përbashkët
3. Normimi- zgjidhja e shqetësimeve për përmbushjen e detyrës.

4. Kryerja – zgjidhja e problemeve rreth lirisë, kontrollit dhe vetë rregullimit.¹²

Disa aspekte kyç të menaxhimit të klasës janë:

Mësime të planifikuara mirë dhe interesante;Zhvillimi i marrëdhënieve pozitive në klasë; Motivimi i nxënësve për të nxënë;Rregullat e klasës;Disiplinë pozitive në klasë;Aftësi komunikuese të mira të mësuesit dhe nxënësve.¹³

Sipas Goleman ekzistojnë gjashtë lloje të udhëheqjes prej të cilave dy stile (lloje) që ndikojnë negativisht dhe katër të tjera që ndikojnë në mënyrë pozitive në krijimin e një klime të favorshme dhe në arritjet shkollore të nxënësve:

1. Stilin detyrues të udhëheqjes („kërkon zbatim të urdhrit” ose „bëni si të them unë”).
2. Stilin autoritar të udhëheqjes (mobilizon njerëzit drejt një vizioni, ose „ejani me mua”).
3. Stilin bashkëpunues të udhëheqjes ,krijon harmoni dhe ndërton lidhje emocionale, ose “njerëzit para se gjithash”).
4. Stilin demokratik të udhëheqjes (kalitë marrëveshjen përmes pjesëmarrjes, ose „si mendoni ju”).
5. Stilin përcaktues të ritmit „cakton standarde të larta të punës” ose „bëni si bëjë unë, qysh në këtë çast”).
6. Stilin trajnues udhëheqës „përgatit njerëzit për të ardhmen, ose “provoje këtë”)

1.4 Formimi i grupeve

Çështja e parë të cilës lipset t’i drejtohem është çfarë lloji apo lloje grupesh të formohen.

Grupe të bazuar në nevoja: Këto grupe formohen për periudha të shkurtra kohe me qëllimin e mbledhjes bashkë të nxënësve me nevoja ose probleme të ngjashme të të mësuarit (për shembull të ri jepen mësime me nxënës me aftësi të veçanta, për të punuar në mënyrë të veçantë me grupe me aftësi ndër-personale).

¹² Bardhyl Musai, Psikologji edukimi, PEGI, Tiranë 1999,fq 162

¹³ Majkëll Fullan,fq,145

Grupe të bazuar në interesa: Këto grupe formohen gjithashtu për një periudhë relativisht të shkurtër kohe për të mbledhur së bashku nxënës me interesa të ngjashëm.

Në qoftë se për shembull ju jepni mësim një element të shkencës për sistemin e qarkullimit të gjakut dhe atë të frymëmarrjes tek kafshët, nxënësit mund të duan ta ndjekin studimin për lloje të ndryshme kafshësh (për shembull arinjtë, merimangat dhe krimbat e tokës). Këto interesa të përbashkëta mund të përdoren për të formuar ekipe kërkimore.

Grupe të ndërtimit të ndryshimeve. Për disa objektiva është e dëshirueshme që të kombinohen në një grup të vetëm nxënës me prejardhje të ndryshme, ose që kanë aftësi apo interesa të ndryshme.

Në qoftë se për shembull ju po jepni një cikël mësimesh në letërsi mbi konceptin e “heroit tragjik”, nxënës me prejardhje të ndryshme mund të kontribuojnë me shembuj nga familjet ose komunitetet e tyre. Ideja do të jetë të tregohet që “heronjtë tragjikë” mund të ekzistojnë dhe ekzistojnë në të gjithë klasat shoqërore, racat e gjinitë dhe në të gjitha periudhat historike.¹⁴

1.4.1 Menaxhimi i grupeve

Pasi është marrë vendimi për të përdorur grupe të vogla si pjesë e programit të përgjithshëm të mësimdhënies, ne duhet të sigurohemi që nxënësit të përgatiten të punojnë me sukses dhe efektivitet në grupe. Vetëm caktimi i nxënësve në grupe, nuk siguron suksesin e studimit dhe punës së grupit të vogël.

Për këtë qëllim mund të nevojitet që në :

Mjedisi në shkollat e Mitrovicës në klasat I-V duhet tua mundësoj nxënësve që nxënësit të jenë të përgatitur siç duhet për çdo detyrë apo aktivitet.

T’iu mësonë nxënësve teknikat për të punuar në grupe, duke i nxitur e ndihmuar njëri-tjetrin kur nevojitet, duke qenë tolerantë për shprehitë, zakonet dhe idetë e ndryshme për punën dhe t që çdo njeri të marrë pjesë aktive dhe asnjë të mos lihet jashtë.

¹⁴ MJEDISËT E TË MËSUARIT, DIMITRIS K. MAVROSKOUFIS, fq65

Në duhet të caktojmë role të veçanta brenda grupit për t'u siguruar që të gjithë pjesëtarët e grupit të marrin pjesë aktive. Për shembull, në një grup me tre pjesëtarë janë të përshtatshëm rolet që vijojnë: **Udhëheqës**. Siguron që të dëgjohet çdonjëri. Përqendron punën në detyrën e caktuar.

Regjistruues. Grumbullon idetë e pjesëtarëve të grupit. **Prezantues**. Paraqet punimin e përfunduar të grupit para klasës, me gojë, me shkrim ose të dyja. **Kohë mbajtësi**. I cili nxit grupin t'i përmbahet detyrës, i kujton grupit kohën e mbetur. **Porositësi** largohet nga grupi për një kohë të shkurtër që të marrë ndihmë nga mësuesi, kur pjesëtarët e grupit janë në një mendje që nuk i kanë vetë aftësitë dhe njohuritë për të zgjidhur një problem të veçantë. Për të nxitur pjesëmarrjen dhe për të pakësuar mërzinë, rolet mund të ndërrohen nga koha në kohë.

Caktoni një kohë limit: Nxënësve duhet t'u japim një afat, në mënyrë që nxënësit ta përcaktojnë vetë ritmin dhe ta përfundojnë në kohë detyrën e caktuar. Pasi nxënësit janë përgatitur, janë caktuar rolet dhe janë shpallur afatet, vëmendja jonë zhvendoset në menaxhim të sjelljes dhe veprimtarive të grupeve dhe pjesëtarëve të tyre.

Këtu janë disa sugjerime për menaxhimin e grupeve.

Uleni nxënësit afër njëri tjetrit :

Uleni afër njëri tjetrit në mënyrë që ata të mund të flasin me zë të ulët e ta dëgjojnë njëri tjetrin. Përgjithësisht për punë në grup preferohen tryezat, por edhe bashkimi i tyre mund të shërbejë për të njëjtin qëllim. **Qarkulloni midis grupeve** duke përdorur afërsinë tuaj fizike për të nxitur dhe për të ruajtur sjelljen dhe diskutimin për detyrën.

Nxitini nxënësit dhe përgjigjuni pyetjeve të tyre ndërkohë që lëvizni nga grupi në grup. Por shmangini diskutimet e zgjatura, duke i bërë ndalesat tuaja të shkurtra dhe duke shmangur faktorët që ju bëjnë pjesëtar të grupit. **Mbani mend se cilët grupe keni vizituar**, në mënyrë që asnjë grup të mos lihet mënjanë ose t'i keni kushtuar më tepër vëmendje.

Formojini përsëri grupet rregullisht në mënyrë që ato të mos kenë gjithmonë të njëjtët pjesëtarë.

Në qoftë se nxënësit po kënaqen me një veprimtari, por për të iu nevojiten edhe disa minuta më tepër, le ta zgjasin atë. Nga ana tjetër, në qoftë se një veprimtari nuk po shkon mirë, është e arsyeshme t'i bini shkurt.

1.5 Disiplina në klasë

Disiplinë janë rregullat ,udhëzimet dhe standardet e sjelljeve të pranueshme që prindërit i përcaktojnë për fëmijët .Disiplinën e përbëjnë kufijtë brenda së cilëve fëmijët mësojnë të sillen në mënyrë të pranueshme nga shoqëria. Disiplina përfshin përgjegjësinë e fëmijës në shtëpi,koha e caktuar për dalje,rregullat familjare ,mbajtja e pastërtisë dhe pasojat për mosrespektim të rregullave .¹⁵

Mendoj që në një klasë ku nuk ka disiplinë aty nuk ka edhe mësim andaj vendosja e rregullave të klasës luan një rol shumë të madh edhe në suksesin e nxënësve në përgjithësi.

Shpeshherë ngatërrohet termi “disiplinë” me termin “ ndëshkim” mirëpo ka dallim ndërmjet tyre ku në disiplinë bëjnë pjesë rregullat dhe pritjet që i kanë mësuesit ose prindërit për sjelljet e fëmijëve të tyre ,ndërsa ndëshkim janë veprimet që mësuesit ose prindërit i ndërmarrin kur rregullat qëllimisht thyhen nga nxënësit ose nga fëmijët.

Qëllimi i masave disiplinore është mësimi dhe orientimi e jo ndëshkimi si qëllim i vetvetes.

Ne si mësime dhënë kemi për qëllim që nxënësit t’i mësojnë të bëhen të vetë disiplinuar në mënyrë që ata të kuptojnë dhe të mësojnë nga gabimet e veta dhe në këtë mënyrë të zhvillojnë vlerat morale.

Para se t’i caktojmë rregullat në klasë duhet të kemi parasysh këto kritere:

- Rregullat duhet të jenë të qarta dhe të qëndrueshme
- Rregullat duhet të ekspozohen në mur
- Rregullat nuk duhet të jenë shumë
- Rregullat duhet të jenë të drejta
- Rregullat duhet të respektohen për të gjithë
- Nxënësit duhet të marrin pjesë në përcaktimin e rregullave
- Në vend të fjalës “Mos” përdoren fjalën “Bëje”
- Kurse kur përdorim ndëshkime duhet të kemi parasysh:
- Kohëzgjatjen e ndëshkimit
- Parimësinë e ndëshkimit

¹⁵ Bonnie Miller”Komunikimi me fëmijë”QPEA,2007,fq49

1.5.1 Strategjitë pozitive disiplinore

Këto strategji kanë qëllim që të parandalojnë sjelljet e padëshirueshme nga fëmijët ose nxënësit. Këto strategji disiplinore nuk janë efektive për të gjithë fëmijët dhe për të gjitha situatat mirëpo mund të modifikohen varësisht nga situata ose nga sjellja e fëmijëve.

Përgatiteni fëmijën se çfarë po ndodh

Çfarë pritni rreth sjelljes së fëmijëve. P.Sh. I tregon çfarë do të bëni ,çka ka drejtë fëmija e çka jo.

Njihuni me ndjenjat e fëmiut

Ne duhet tu tregojmë fëmijëve se po i kuptojmë ata çka mendojmë dhe si ndihen dhe kur ata e vërejnë se ne po i kuptojmë atëherë ata janë të pirur për përgjigje pozitive.

Ofroni zgjedhje ,në vend se të jepni urdhëra

Ofro zgjidhje ndërmjet dy alternativave të pranueshme.

Zgjidhni problemet bashkërisht

Ne si mësues duhet që të mendojmë bashkërisht rreth zgjedhjeve të mundshme dhe ti provojmë disa zgjedhje nëse njëra zgjedhje nuk ju hyn në punë.

Siguroni forcë pozitive

Në momentin kur fëmija sillet mirë duhet ta lavdërojmë dhe ta nxisim atë në mënyrë që ai të përqendrohet më tepër në përpjekjen e jo në rezultatin.

Shpërqendrojeni vëmendjen e fëmijës

Nëse ndodh ndonjë sjellje e padëshirueshme në klasë gjatë orës mësimore atëherë ne duhet ta shpërqendrojmë vëmendjen e fëmijës nga konflikti në një aktivitet të ri,duke përdorur imagjinatën,lojën

Lejoni fëmijët që t'i përjetojnë pasojat e veprimeve të tyre.

Nganjëherë është mirë që fëmija të bëhet i pavarur duhet ta lejojmë edhe të gaboje në mënyrë që herën tjetër ta mësojë si bëhet.¹⁶

Metoda TIME OUT

Kjo metodë përdoret prej moshës 3-9 .Me anë të kësaj metode fëmijët mësojnë se sjellja e tyre është e papranueshme dhe se nuk mund të arrijnë atë që e dëshirojnë duke u sjellë në mënyrë të pahijshme .

Me anë të kësaj metode fëmija ndahet nga çdo ndikim ,duke përfshirë edhe vëmendjen negative që do ta tërheqë ai. Me TIME OUT fëmijës i epet kohë për të menduar , për tu qetësuar dhe për të menduar për mënyrën tjetër me të cilën do të arrihet qëllimi.¹⁷

1.6 Marrëdhënia mësues –nxënës

Çdo gjë që bëjmë në marrëdhëniet tona me fëmijët është një formë komunikimi. Madje jo vetëm fjalët ,por edhe ngjyra e zërit ,shprehjet e fytyrës dhe gjuha e trupit gjestet,kanë ndikim në jetën e fëmijës.

.Mënyra e komunikimit tonë me fëmijët mund të dërgojë porosi të respektit, dhe të kujdesit, por gjithashtu mund të dërgojë edhe porosi të kundërta. Nëpërmjet dëgjimit aktiv,nxitjes së fëmijëve që të flasin për ndjenjat e veta dhe nëpërmjet përdorimit të një gjuhe pozitive ,ne ua bëjmë me dije atyre se mund të kenë besim tek ne.

Përveç kësaj komunikimi ynë është një model për fëmijët në komunikimin e tyre me të tjerët,për zgjidhjen e problemeve ,për të qenë pozitiv dhe të durueshëm për t'i dëgjuar edhe të tjerët.¹⁸

Shtrohet pyetja:Çfarë e vështirëson komunikimin?

Ja disa shkaktarë që e pengojnë komunikimin:

Urdhëratë, kërcënimet,gjykimet,fajësimet,kureshtja,marrja në pyetje, ligjërata ,supozime etj.

Ne si mësues duhet të krijojmë marrëdhënie të mira me nxënësit në klasë sepse nëse nuk kemi marrëdhënie pozitive dhe qasje pozitive ndaj tyre atëherë pa bashkëpunim nuk mund të arrijmë sukses.

¹⁶ Bonnie Miller”Komunikimi me fëmijë”QPEA,2007,fq46,47

¹⁷ Bonnie Miller”Komunikimi me fëmijë”QPEA,2007,fq,53

¹⁸ Bonnie Miller “Komunikimi me fëmijë” ,QPEA,20017,fq18

Në kohën në të cilën po jetojmë sipas mendimit tim shkollat janë duke kaluar në një proces të ridefinimit të rolit të mësimit. Tani nxënësit janë në qendër kurse mësimit janë mbështetës, përkrahës, motivues të nxënësve në mënyrë që suksesi të mos mungoj.

Unë mendoj që mësuesi duhet të bëjë në nivelin e nxënësve dhe t'i kuptoj ata, dëshirat e tyre, kërkesat e tyre duhet t'u tregoj nxënësve se gjithkush bën gabime se edhe mësuesi bën gabime por nga gabimet duhet të marrin mësim që mos të përsëriten. Mësuesi duhet t'i çojë virtetet e nxënësve, t'i respektoj nxënësit dhe ata do ta vërejnë që mësuesi është në anën e tyre dhe punon për interesat e tyre dhe në këtë mënyrë rritet besimi i cili i nxit nxënësin për nxënie më të mirë.

Mësimit duhet t'i shfrytëzohen teknikat interaktive për t'i ofruar ndihmë nxënësve gjatë situatave konfliktuale.

Po ashtu mendoj që mësimit nëse përdorin metoda atraktive, aktivitete argëtuese atëherë nxënësit e tyre do të jenë më të motivuar dhe do të fitojnë besimin tek mësuesi dhe do t'i kapërcejnë distancat psikologjike ndërmjet tyre dhe nxënësve.

Mësuesi është personalitet i mëshirshëm, ai identifikon nevojat e nxënësve, nxit shpesh me fjalë dhe i trimëron vazhdueshëm nxënësit që të mos ndalen, ai me shembullin e vet tregon entuziazëm për nxënien e njohurive të reja, nxënësit atë e shohin si shembull për zhvillimin intelektual dhe dëshirën për dije në mënyrë të vazhdueshme.

Mësuesi duke treguar qëndrim të hapur ndaj atyre që janë të ndryshëm, me aftësi të kufizuara, me bindje të ndryshme, me jetimë, ose me fëmijë me kushte jo të mira sociale ai zhvillon dhe kultivon tolerancën ndaj fëmijëve, humanitetin, solidarizimin me ta, ndihmën ndaj tyre etj.

Mësuesi si personalitet reflekton me sjelljet e tij, qasjen e tij te secili nxënës andaj çdo sjellje e mësimit duhet të shikohet mirë nga ata sepse mund të ndikoj shumë keq në nxënien dhe edukatën dhe sjelljet e nxënësve në përgjithësi.

2.1 Faktorët kryesor në menaxhimin e klasës

Menaxhimi, (*ang.*: management - *sq.*: udhëheqje, prirje, *lat.*: manum agere = prijë me dorë), nënkupton planifikimin, organizimin, udhëheqjen, koordinimin dhe kontrollin një organizmi (të përbër nga një ose më shumë njerëz ose grupe) për të arritur qëllimin e caktuar.¹⁹

Mary Parker Follett, (1868–1933), e definoi menaxhimin si "arti për realizimin e veprimeve përmes njerëzve", kurse Henri Fajol¹ konsideronte se menaxhimi përbëhet prej pesë funksioneve: planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli.²⁰

Mbi menaxhimin janë dhënë lloje të ndryshme të definicioneve nga ato më të thjeshtat si "menaxhimi është ajo çka menaxherët bëjnë" gjer tek ato më të detajuarat.

Njeriu i cili kryen këtë funksion njihet si menaxher ose udhëheqës. Procesi i menaxhimit përbëhet nga 5 faza: identifikimi i problemit, planifikimi, vendosja, zbatimi dhe kontrollimi.

Për secilën fazë duhet të posedohen informacione specifike. Pastaj një komunikim i gjerësishëm mes pjesëmarrësve të të gjitha fazave është i nevojshëm.

Praktikat primare të procesit të menaxhimit përbëjnë:

- Identifikimin i aktiviteteve dhe detyrave të nevojshme.
- Kontrollimin i mënyrës përkatëse të parashikuar.
- Planifikimin dhe ndërtimin i resurseve dhe infrastrukturës së nevojshme.
- Kujdesin për mbarëvajtjen e plotë të punës së nevojshme.
- Mbikëqyrjen e ecursisë së punës.
- Kontrollimin i produkteve të ecursisë së punës dhe vlerësimin i rezultateve.
- Drejtimin e korrekturës gjatë shmangieve.
- Kontrollimin e rezultatit përfundimtar.²¹

¹⁹ www.menaxherat.com

²⁰ www.wikipedia.org

²¹ <https://dspace.aab-edu.net>

2.2 Synimet e menaxhimit të klasës

Mësuesit duhet t'i nxitin nxënësit ta hulumtojnë botën, t'u ndihmojnë në parashtrimin e pyetjeve dhe në kërkimin e përgjigjeve edhe ta sfidojnë dhe ta kuptojnë kompleksitetin Bruks²² Rregulli për hir të rregullit është një synim bosh. Nuk është etike të përdoren teknikat e menaxhimit të klasës thjesht për të mbajtur në qetësi nxënësit. Atëherë, pse duhet punuar kaq shumë për të menaxhuar klasën?

Ka të paktën tri arsye pse është i rëndësishëm menaxhimi:

1. Më shumë kohë për të nxënit. Nxënësit do të mësojnë vetëm atë material që e kanë mundësi të mësojnë. Në qoftë se ora e mësimit nuk mbulon një pjesë të lëndës, nuk mund të mendohet qënxënësit do ta mësojnë atë.
2. Një nga synimet e rëndësishme të administrimit të klasës është rritja e sasisë së minutave që i kushtohen të nxënit. Kjo, ndonjëherë, quhet **koha e lejuar**.
3. Koha e shpenzuar në mënyrë aktive, duke ndjekur detyra të veçanta mësimore, shpesh quhet **koha e angazhuar** ose siç quhet ndonjëherë koha e detyrës.

Kështu që synimi idytë i administrimit të klasës është përmirësimi i cilësisë së kohës që përdoret duke i mbajtur nxënësit të angazhuar në mënyrë aktive.²³

Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin, organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënit duke synuar që maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim. Është e rëndësishme të theksojmë se menaxhimi i klasës fillon me zhvillimin e ndërtimit të

besimit dhe marrëdhënieve midis nxënësve.

Menaxhimi i klasës është definuar si dispozitë dhe procedurë e nevojshme për të krijuar

²² Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI/ (autorë: Kate Burke Ēalsh, Suzana Kiranxhiska, Tatjana Lazarevski, Gjorgjieva), - Shkup:

²³ Musai Bardhyl, Metodologji e mësimdhënies, Tiranë 2003, fq 224

dhe ruajtur një mjedis në të cilin jepen udhëzime dhe të mësuarit mund të ndodhë. Rregullat e klasës janë shpesh hapi i parë i një mësimit në menaxhimin e klasës. Mësuesi duhet të vendosë se kush do të bëjë rregullat dhe se si ato do të mësohen nga nxënësit, ndërsa gjithashtu duke marrë parasysh edhe se si rregullat do të perceptohen nga nxënësit²⁴.

Pasi që vendosen rregullat, mësuesit duhet t'i monitorojnë sjelljet e nxënësve për t'u

siguruar se rregullat janë duke u ndjekur. Shumë mësues mundohen për të gjetur një mënyrë për të monitoruar sjelljen e nxënësve. Organizatori më i dobishëm për menaxhimin e klasës është shkalla e kontrollit që ushtron mësuesi mbi nxënësit dhe klasën.

2.3 Aspekte kyçe të menaxhimit të klasës janë:

Menaxhimi i klasës përfshin : Mësime të planifikuara mirë dhe interesante; Zhvillimi i marrëdhënieve pozitive në klasë; Motivimi i nxënësve për të nxënë; Rregullat e klasës; Disiplinë pozitive në klasë; Aftësi komunikuese të mira të Mësimit dhe nxënësve (ILO-IPEC, 2006)

Shkolla bashkëkohore është një shkollë ku nxënësit përjetojnë demokracinë, bashkëpunimin dhe ndershmërinë. Nxënësit mësojnë së bashku si një komunitet, ata ndërveprojnë dhe ndajnë eksperiencat së bashku.

Kjo shkollë e percepton të nxënësit dhe sjelljen në terma psikologjikë dhe sociologjikë. Si rezultat, nxënësit shikohen si individë, potenciali i të cilëve mund të zhvillohet në maksimum, nëse u jepet mundësia. Institucionet e arsimit e përmbushin këtë mision vazhdimisht duke mbledhur informacionet mbi kënaqësinë e nxënësve.

Fokusi është që të krijohet një atmosferë pozitive dhe mbështetëse për të nxitur kështu

fuqinë e nxënësit. Theksi vihet te vetë disiplinimi, pra nxënësit kanë përgjegjësi për veprimet e tyre .

Nxënësit mund të shfaqin pikëpamjen e tyre, kështu mund të kujdesen për nevojat e tyre.

Si

²⁴ Anderson, C., & Spaulding, S.A., Using positive behavior support to design effective classrooms, Chicago 2007

drejtuesi edhe mësuesit janë mendjehapur dhe u përgjigjen çështjeve në mënyrë objektive. Nëse një shkollë qëndron e bashkuar si një komunitet dhe anëtarët janë të lidhur me njëri tjetrin, ka të ngjarë që në këtë shkollë të mbizotërojë një klimë pozitive.

Sjellja e individëve brenda një shkolle formon klimën e saj. Sjellja e drejtuesit, sjellja

e mësuesve, sjellja e nxënësve dhe sjellja e prindërve konstituojnë klimën e shkollës. Për më

tepër, klima që mbizotëron në shkollë, tregon për ndërveprimin që ekziston midis drejtuesit dhe mësuesve, mësuesve dhe mësuesve, mësuesve dhe nxënësve si dhe midis prindërve dhe shkollës²⁵.

2.4 Strategjitë e disiplinës

Mendoj që një element tjetër, për humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, në të vërtetë me peshë të madhe në krijimin e një klime të përshtatshme në shkollë, është edhe disiplina e ashpër në mjediset shkollore, përkatësisht kërkesat e shumta dhe të panevojshme në emër të ruajtjes së një rendi në shkollë.

Çelësi kryesor për të vendosur një disiplinë të mirë në klasë, qëndron në atë që nxënësit të pranojnë autoritetin e mësuesit për të drejtuar dhe kontrolluar sjelljen dhe përparimin e tyre gjatë të nxënësve. Të nxënësve nuk do të jetë efikas në një klasë me 30-40 nxënës, nëse mësuesi nuk ka autoritetin për kontroll, për të drejtuar, si dhe për të orientuar atë që po ndodh dhe si po ndodh.

Mësimdhënësi duhet t'i vetëdijësojë nxënësit se ai është pjesë përbërëse e klasës, ka status,

kompetencë, kontroll dhe është ai që përballon me sukses çdo pasojë të sjelljes së keqe të

nxënësit.²⁶

Kur mësimdhënësi të ketë ndërtuar një autoritet të pakontestueshëm profesional, një qëndrim të formuar etik dhe të dëshmojë përgjegjshmëri profesionale dhe korrektësi ndaj nxënësve, atëherë padyshim se arrin edhe realizim të mësimdhënies së suksesshme.

²⁵ Willower, D, J. Eidell, T. L & Hoy, E. K, The school and Pupil control Ideology, Educational Research, New York 1973

²⁶ Karaj, Theodhori, Menaxhimi i klasës, Tiranë, 2008, fq 130

Mosarritja mosrealizimi i këtyre kriterëve a cilësive ndikon në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në masën e duhur për mësim dhe rrjedhimisht edhe në rënien e cilësisë së mësimnxënies në shkollë.

Në shkollat tona, disiplina konsiderohet një prej problemeve kyçe në listën e problemeve me të cilat ballafaqohen shkollat.

Sjelljet, që pjesa më e madhe e mësuesve i konsiderojnë shqetësuese, nuk janë akte dhune, por kryesisht probleme të zakonshme siç janë: organizimi i dobët në shkollë, shkalla e ulët e përgjegjësisë së mësimdhënësve në shkollë, mos pjesëmarrje e rregullt e nxënësve në procesin mësimor etj

2.5 Rregulli në klasat I-V në shkollat e komunës së Mitrovicës

Rëndësi të madhe në menaxhimin e klasës ka vendosja e rregullave dhe autoritetit të mësimdhënësit në klasë. Një klasë ku ka rend dhe rregull aty ka edhe sukses sepse gjitha ndërliken me procesin e të nxënësve mirëpo përcaktimi i rregullave varet shumë nga aftësitë e mësimdhënësit për ti vënë në zbatim ato rregulla.

Mendoj se rregullat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit .Fillimisht në klasën e parë vendosen rregulla më të thjeshta dhe më të kuptueshme dhe të zbatueshme për nxënësit. Pastaj duke u ngritur niveli nga klasa në klasë plotësohen me rregulla shtesë.

Nxënësve vazhdimisht duhet rikujtuar rregullat derisa ata ti zotërojnë ato dhe ti zbatojnë në praktikë.

Gjatë përpilimit të rregullave duhet nisur nga aspekti pozitiv duke mos përdorur fjalët urdhërore, mohuese p.sh: Mos bëni zhurmë, në vend të kësaj fjale mund të përdorim fjalën p.sh : “Mbajmë qetësi në klasë” p.sh “Mos fol kur flet mësuesja”... në vend të kësaj fjale mund të përdorim fjalën:”Mësuesja kur flet nxënësit dëgjojnë”...

Ajo që është kryesore për nxënësit është që t'i kuptojnë rregullat dhe të kuptojnë se rregullat dhe ligjet janë të krijuara për shkak të sigurisë sonë, që t'i mbrojnë lirinë dhe të drejtat individuale të njerëzve dhe të na drejtojnë se si duhet të sillemi në klasë.

- **RREGULLA TË SJELLJES ,DËGJO ME VËMENDJE**
- **ZBATOJI DETYRAT,BËHU SHOK I MIRË**
- **SJELLU ME KULTURË,LËJI GJËRAT NË VEND TË VET**

Mësuesi i sjell rregullat së bashku me nxënësit, ose, nëse nxënësit janë më të rritur, atëherë ai mund të lë vetë të vendosin cila rregulla do t'i sjellin. Mësuesit duhet t'i përkujtojnë nxënësit se ato duhet të zgjedhin disa rregulla konkrete. Rregullat e përcaktuara duhet të jenë të shkruara në hamer të madh i cili do të jetë i vënë në klasë në vend prej ku nxënësit lehtë dhe qartësisht do ta shohin.²⁷

2.6 Cilësitë e mësimitdhënësit të mirë

Duke u bazuar në përvojën time 14 vjeçare si mësimitdhënëse e klasave I-V vlerësoj që një mësimitdhënëse përveq përgatitjes profesionale duhet ta don punën me fëmijë dhe të ketë një personalitet i cili është shembull për nxënësin sepse personaliteti ,qendrimi i mësimitdhënësit ,botëkuptimet e tij reflektojnë tek nxënësit ,po ashtu një mësimitdhënësi i mirë është edhe aktrues i mirë i cili i jep shpirt përmbajtjes ku krahas aspektit shkencor e bën atë edhe më të kuptueshme për nxënësit.Po ashtu një mësimitdhënësi i mirë është i afërt me nxënësit ,është frymëzues ,motivues i cili përdor ndonjëherë edhe humorin në mënyrë që nxënësit të relaksohen në momente të caktuara kur është nevoja .

Një mësimitdhënësi i mirë është organizues i mirë i klasës ,gjithpërfshirës ,mbështetës dhe përkrahës i nxënësve që kanë nevojë.

Në procesin e mësimitdhënies, mësuesit i duhet të kryejë disa role. Ja disa prej tyre:

Mësuesi motivues. Asgjë nuk vjen si rezultat automatik ose magjik në të nxënësit e nxënësve.

Një nga rolet më të rëndësishme është ai i motivuesit. Pyetja qendrore e mësimitdhënies është: “Si mund t’i mbaj nxënësit të përfshirë në mënyrë aktive gjatë mësimit?”

Mësuesi - menaxhues. Menaxhimi përfshin vëzhgimin e veprimtarive në klasë organizimin e mësimeve, përgatitjen e detyrave me shkrim dhe testeve, vlerësimin e detyrave, ndihmën që u jepet nxënësve që e kërkojnë, konsultat me mësues të tjerë, takimet me prindërit etj.”²⁸

²⁷ Krijimi i mjedisit për të nxënësit për shekullin XXI/ (autorë: Kate Burke Ēalsh, Suzana Kiranxhiska, Tatjana Llazarevski, Gjorgjieva), - Shkup:

²⁸ Grup autorësh, (2009) Mësimitdhënia dhe mësimit në shek. XXI, Shkup, fq. 35

Mësuesit e mirë e njohin lëndën e vet dhe ndjejnë kënaqësi në të. Në përgjithësi janë të vetëdijshëm, se sa është lënda e tyre interesante dhe si nxënësve mundën t'iu ofrojnë kënaqësi të madhe, nëse ai është mjaft i prirë që ta bëjë të këndshëm.

Mësuesi i mirë kërkon që nxënësit të lëshojnë klasën me pyetje të shumta duke zgjuar interesimin dhe vëmendjen për mësimin.

Mësuesit e mirë e ushtrojnë vetë disiplinën dhe kanë ndjenjë të saktë se si „të vërtetat e mëdha t'i shpjegojnë në mënyrë të thjeshtë dhe jo të vërtetat e thjeshta në mënyrë të komplikuar”.

Mësuesit e mirë e njohin lëndën e vet dhe ndjejnë kënaqësi në të. Në përgjithësi janë të vetëdijshëm, se sa është lënda e tyre interesante dhe si nxënësve mundën t'iu ofrojnë kënaqësi të madhe, nëse ai është mjaft i prirë që ta bëjë të këndshëm.

Mësuesit e mirë presin mjaft nga nxënësit e tyre dhe këtë iu bëjnë të ditur, por në mënyrë të kujdesshme dhe të butë. Ai i nxitë dhe i vlerëson ata nxënës të cilët tregojnë interesim për lëndën e tij, me çka tek ata nxënës rritë dëshirën dhe dashurinë për lëndën, dhe në të njëjtën kohë edhe ndaj mësuesit.

2.6 Mësimdhënia si proces

Mësimdhënia është një proces jo i lehtë, është veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe me përgjegjësi. Ka mendime se mësimdhënia është art, është shkencë, apo të dyja së bashku. “Nëse është mësimdhënia art, kërkon frymëzim, intuitë, talent e krijimtari dhe pak prej tyre mund të mësohen.

Pra sipas mendimit tim mësimdhënia është një proces i cili planifikohet, drejtohet, organizohet nga mësimdhënësi sipas stileve të të nxënit dhe me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, ku përvetësohen njohuri, përdoren metoda, teknika ndërvepruese, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë. Nëse është shkencë, mësimdhënia kërkon njohuri dhe shprehje që me të vërtetë mund të mësohen. Ne mund të shprehim mendimin tonë se mësimdhënia e suksesshme ka këto dy anë.

Mësimdhënia më e mirë është ajo gjatë se cilës përmbushen objektivat, aktivizohet nxënësi, nxitet ndërveprimi, përdoren pyetje të niveleve më të larta, ku nxënësi është në qendër të mësimdhënies, zhvillohen aftësitë, të menduarit kritik dhe krijues.

Dimensioni parësor i mësimdhënies është zgjerimi dhe ngritja e lidhjeve në mes të mësuesit dhe nxënësit, si dhe lidhja e dijeve të caktuara nga lëndë të ndryshme.

Në botën reale nuk ndeshim probleme të cilat janë të thjeshta dhe për zgjidhjen e të cilave nuk është e nevojshme gërrshetimi i dijeve dhe përvojave të ndryshme.

Mësuesit e shkëlqyeshëm i ndihmojnë nxënësve se si të integrojnë dije të caktuara dhe të dinë t'i përdorin në mënyrë kualitative në botën në të cilën na rrethon.²⁹

2.6.1 Mësimdhënia bashkëkohore

Vet emërtimi mësimdhënie bashkëkohore nënkupton një mësimdhënie ndryshe nga ajo tradicionale. Kjo nënkuptohet në shumë aspekte si: në strategji, metoda, teknika, forma, ndryshimin e rolit të mësimdhënësit dhe nxënësit, mjedisin shkollor, në respektimin e të drejtave të fëmijëve, në të kuptuarit dhe të menduarit ndryshe, në përcaktimin e objektivave, në vlerësim etj.

Prandaj "Me mësimdhënie bashkëkohore duhet të kuptojmë atë lloj mësimdhënie, e cila lehtëson me forma, metoda, teknika, dhe strategji të përshtatshme në procesin e të nxënësve të nxënësve.

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton të nxënësve aktiv, të menduarit në mënyrë kritike, krijuese dhe të nxënësve me nxënësin në qendër. "Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse dhe kërkon njohuri, aftësi e shprehje të shumta.³⁰

Duke zbatuar ma shumë se një dekadë mësimdhënien bashkëkohore në klasën time mendoj dhe vlerësoj se procesi mësimorë bëhet duke u mbështetur në metodat dhe teknikat bashkëkohore, ku nxënësi mëson duke reflektuar, vlerësuar, zbuluar dhe duke zgjidhur probleme. Ajo është një proces, veprimtari që ndryshon vazhdimisht.

Në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi nxitet në procesin mësimorë, me veprimtari të ndryshme për përvetësimin e diturive të reja, gjithëherë duke u mbështetur në përvojën, interesin, nevojat dhe

²⁹ Bardhyl Musai, Psikologji edukimi, PEGI, Tiranë 1999, fq. 153

³⁰ Musai, B. (2003). Metodologjia e mësimdhënies. Tiranë :CDE ,fq. 11.

aftësitë e tyre. Prandaj edhe burimet e informacionit janë të shumta dhe të ndryshme si nga: mësimdhënësi, nga përvoja, tekstet, interneti etj.

. Në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi është aktiv, ai e kupton atë që mëson, i vërteton dhe praktikon njohuritë e mësuara. Ata nxiten për të menduar në mënyrë kritike.

Gjatë veprimtarive mësimore nxënësit krijojnë, bashkëbisedojnë, diskutojnë, shqyrtojnë, zgjidhin problemet, zbulojnë (hetojnë), kritikojnë, analizojnë, gjykojnë.

Për ndryshim nga mësimdhënia tradicionale, në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi mendon për atë që mëson, e përdorë në jetën e përditshme, ndërton përvojën dhe aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur.

Sot nxënësi, interesat, aftësitë, prirjet, nevojat janë pikëmbështetje e të gjitha strategjive bashkëkohore të mësimdhënies. Prandaj njohja e nxënësit përmes dosjeve, mbledhjeve të prindërve, vëzhgimit, testeve vlerësuese etj. është një çështje që duhet ta ketë parasyshë çdo mësimdhënës për ta organizuar një mësimdhënie cilësore dhe frytëdhënëse.

Shkolla bashkëkohore niset nga përvoja e nxënësit duke i stimuluar ata për aktivitete praktike (puna e tyre në kabinete të ndryshme; kimise, fizikës, punëtorinë e shkollës etj.), ti zgjerojë dhe t'i pasuroj ato aktivitete.

Në fund, mësuesit e shkëlqyeshëm duhet të pranojnë mundësitë e nxënësve të tyre dhe të përpiqen që ato mundësi t'i zhvillojnë dhe jo të shtypin shpirtin e tyre dhe kështu të shndërrohen në vrases të inteligjencës së tyre dhe mundësisë që të japin më tepër.

Derisa është pikërisht mësimdhënësi ai që ka rol të drejtpërdrejtë, të rëndësishëm gati po aq sa prindi, në ndërtimin e personalitetit të nxënësit, në zhvillimin e tij të përgjithshëm, në kultivimin e vlerave të tij shoqërore, si tolerancës, bashkëpunimit, vetëpërgjegjësisë etj.³¹

³¹ Bonnie Miller: "Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit", QPEA, Prishtinë 2003

2.6.2 Mësimdhënia bashkëkohore mbështetet në parime

Problemi i mësimdhënies në shkollat fillore të komunës së Mitrovicës shqetëson prindërit ,nxënësit si dhe mësimdhënësit andaj në krejt Kosovën janë bërë reforma dhe ka filluar të aplikohet mësimdhënia bashkëkohore e cila mbështetet në disa parime:

- Aftëson nxënësit për të nxënit e pavarur,
- Nxitë nxënësit që të jenë nismëtar,
- Krijohet dallueshmëri në të nxënë dhe nxitet të menduarit kritik, krijues
- Nxitë dhe krijon kushte për komunikim shumëkahor dhe të frytshëm
- Aftëson nxënësit për vlerësim dhe vetëvlerësim.

Kjo njëherit kërkon nga mësimdhënësi njohjen e stileve të të nxënit, përcaktimin e objektivave mësimorë, përgatitjen e pyetjeve sipas niveleve të shkallshmërisë së Blumit, përfshirjen e sa më shumë faktorëve në procesin mësimorë.

Mësimdhënia bashkëkohore i aftëson nxënësit, i nxitë ata në veprimtaritë mësimore, t'i gjejnë vet burimet e informacionit, të zhvillojnë aftësitë, shkathtësitë dhe formojnë shprehitë e tyre. Për arritjen e këtyre rezultateve duhet krijuar kushte, një mjedis të përshtatshëm mësimorë.”

Prandaj detyrë e mësuesit është të krijoj një mjedis sa më të përshtatshëm dhe mjedis të ngrohtë pune, ku secili nxënës të ndjehet lirshëm të shprehë mendimin e vet, të besoj në vetvete, të besojnë te mësuesi dhe shokët e tij. Në mësimdhënien bashkëkohore planifikohen metoda, teknika, forma të përshtatshme në procesin mësimorë, ku edhe ndryshon pozita e nxënësit dhe mësimdhënësit, ku shkolla është më e hapur ndaj mjedisit shoqëror.

Prandaj për të arritur rezultate dhe suksese duhet që në planifikimin e punës mësimore të përfshihen më shumë strategji gjithpërfshirëse dhe me nxënësin në qendër, për të përmbushur një mësimdhënie dhe të nxënë cilësor.

Dhe në këtë punë mësimdhënësi është faktori i parë që duhet qasur në mënyrë të qetë, me takt, të afërt e me ngrohtësi, duke e bindur secilin nxënës se mendimet, vërejtjet eventuale a sugjerimet e tjera që në çfarëdo mënyre lidhen me shkollën do të merren parasysh.

Është ky aspekt i rëndësishëm i ndërtimit të raporteve të mira mësimdhënëse - nxënës, si hallkë e domosdoshme për arritjen e rezultateve të dëshirueshme në suksesin e nxënësve dhe në cilësinë e përgjithshme të mësimnxënies, kriter i domosdoshëm për shkollën moderne.

2. 7 Strategjitë e krijimit të bashkëpunimit në klasë

Asnjë veprimtari produktive nuk mund të ndodhë në një grup pa bashkëpunimin e të gjithë anëtareve e sidomos bashkëpunimin e mësimdhënësit me nxënësit.

Detyra themelore e administrimit për mësimdhënësit është ta arrijë rregullin ndërmjet tërheqjes por dhe sigurimit të bashkëpunimit të nxënësve në veprimtaritë e klasës.

Të tërheqësh bashkëpunimin e nxënësve do të thotë shumë më tepër sesa të merresh në mënyrë efektive me çrregullimet në sjellje.

Një gjë e tillë do të thotë të planifikosh veprimtari, të bësh gati materialet, t'i japësh nxënësit kërkesat dhe detyrat e duhura mësimore dhe të sjelljes, t'i parashikosh problemet dhe t'i ndalosh ato përpara se të nisen, të përzgjedhësh dhe të ndjekësh në mënyrë që të mbash rregullin dhe ecurinë normale.

Përmes përvojës dhe ndërtimit të saj, nxënësit i kuptojnë përmbajtjet e reja duke i zgjeruar e pasuruar ato në mënyrë kritike.

Përvoja vetanake e nxënësve, interesat, nevojat dhe aftësitë janë thelbësore gjatë mësimdhënies dhe të të nxënësve. Mësimdhënia bashkëkohore tejkalon të nxënësve riprodhues dhe krijon kushte për të nxënësve aktiv dhe zhvillimin e të menduarit. Pra kemi të bëjmë me një mësimdhënie cilësore, kjo do të thotë se nxënësi duhet të jetë në gjendje të bëjë rindërtimin e ideve, koncepteve, mendimeve përmes procesit të njohjes,

veprimet dhe ndërveprimet duke përdorur të menduarit dhe funksionet e tij si: analizën, sintezën, përfundimin, gjykimin, krahasimin, vlerësimin

3.1 Motivimi i nxënësve në klasat I-V në komunën e Mitrovicës

Një prej kërkesave thelbësore të mësimdhënies bashkëkohore është realizimi i një mësimdhënieje atraktive me nxënës në klasë, si parakusht për motivimin e duhur të nxënësve për mësim.

Mendoj që motivimi jo i mjaftueshëm i nxënësve nga mësimdhënësi ndikon drejtpërdrejt në

angazhimin, përkatësisht mosangazhimin e nxënësve për mësim ose, thënë më ndryshe, ndikon dukshëm në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në procesin mësimor në klasë, pra për të qenë aktivë gjatë këtij procesi si dhe për të treguar shenja pasiviteti në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Po ashtu motivimi i nxënësit nuk varet vetëm nga ngarkesa emocionale vetjake, por edhe nga qëndrimi ndaj lëndës që mësohet, përvojës, interesave, vështirësive të të nxënës, klimës që krijohet në klasë. Nxënësit do të kenë motiv më të madh atëherë kur detyrat e tyre të jenë pak mbi mundësitë e tyre. Motivimi i nxënësve varet edhe nga ajo se sa motivohen nga prindërit e tyre në shtëpi për të mësuar.³²

Nxënësit që vijnë në klasat joformale mësojnë dhe nxënë më mirë atëherë kur janë të motivuar.

Kjo ndodh atëherë kur ata: Janë të qartë për veprimtaritë që po kryejnë dhe qëllimin që ato kanë, Mund të punojnë vetë duke u mbështetur në njohuritë që ata vetë kanë, Marrin pjesë aktivisht gjatë zhvillimit të veprimtarive duke i krijuar hapësirë që të përdorin gjuhën dhe perceptimet e tyre për të kuptuar.

Përveç kësaj, nxënësit që marrin pjesë në këto klasa do të përfshiheshin më aktivisht në veprimtaritë e zhvilluara në qoftë se ata:

Kanë një mjedis të përshtatshëm dhe i siguron mundësi të punojnë së bashku me të tjerët dhe po ashtu e çliron nga presioni i notës apo i gabimit, kanë një sërë mundësi zgjedhjesh për çfarë, kur dhe si duan të mësojnë, kanë kohë të mendojnë dhe të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar.³³

³² Teuta Karaj, Përvoja të mira të ciklit fillor, Peshkopi 2006, fq23

³³ Teuta Karaj, Përvoja të mira të ciklit fillor, Peshkopi 2006, fq 25

3.1.1 Si mund të ndihmoni fëmijën për të ndjekur shkollën ?

Nëse ndonjë fëmijë nuk ka dëshirë të ndjek shkollimin atëherë ne si mësime dhënë duhet që t'ua bëjmë atyre shkollimin sa më atraktiv në mënyrë që ata të ndihen të pranueshëm nga shokët dhe shoqet e klasës dhe të përfshihen në ato aktivitete që ai nxënës i ka dëshirë.

Ne duhet t'i ndihmojmë nxënësit që ta ndërtojnë vetbesimin duke kuptuar që ata janë me vlerë ,që mësuesja i don,që shkolla është e mirë,që të ndihen mirë në klasë etj .

Ne si mësime dhënë duhet të gjejmë shkaktarët që ndikojnë që fëmija mos të ketë dëshirë që ta ndjek mësimin dhe kur dihen ata shkaktarë atëhere duhet që në bashkëpunim me prindërit ,shokët ,shoqet e klasës t'i eliminojmë ata.

6.1.1.Rekomandimet

- ✓ Të reduktohet numri i nxënësve në klasa sepse e veshtirëson menaxhimin e klasës.
- ✓ Mësime dhënësit të trajnohen për menaxhimin e sjelljeve të padëshirueshme.
- ✓ Mësime dhënësit të përdorin sa ma pak metoda ndëshkuese në klasë.
- ✓ Gjatë përdorimit të metodave ndëshkuese të kenë kujdes në efektin negativ që mund ta kenë te nxënësit.
- ✓ Bashkëpunoni me nxënës duke i motivuar në mënyrë të vazhdueshme nxënësit.
- ✓ Përzgjedhni metoda -teknika adekuate gjatë mësime dhënies .
- ✓ Planifikoni mirë kohën për realizim të qëllimeve.
- ✓ Përdorni shumë stile të mësime dhënies në klasë.
- ✓ Të zgjatet kohëzgjatja e orës mësimore.
- ✓ Krijoni kushte të mira në shkolla sepse kjo ndikon në zvogëlimin e sjelljeve të padëshirueshme në klasë.
- ✓ Krijoni marrëdhënie të mira me nxënësit duke i ruajtur ato vazhdimisht .
- ✓ Shkolla të digjitalizohet sa më shpejt.
- ✓ Të përputhen rezultatet që synohen të arrihen në klasë me kohën që e kemi në dispozicion për t'i realizuar ato në klasë.
- ✓ Të evitohen shkaktarët që e vështirësojnë menaxhimin e sjelljes dhe disiplinës në klasë.

- ✓ Të evitohen shkaktarët që e vështirësojnë menaxhimin e kohës në klasë
- ✓ Të krijohet klimë pozitive në klasë duke e përdorur stilin gjithpërfshirës në menaxhimin e klasës.
- ✓ Motivoni nxënësit duke përdorur metoda atraktive në klasë.
- ✓ Përdorni strategjitë efektive në menaxhimin e klasës

6.2 Referencat

- Gary D. Borich, përkthyer nga Bardhyl Musaj , Metodologjia e mësimdhënies ,2003
- ipkmasht.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2015/11/Shkaqet-e-humbjes-se-interesimit-te-nxenesve-permesim.pdf
- Bardhyl Musai, Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies
- Musai Bardhyl, Psikologji edukimit, Tiranë ,1999
- Suzana Kiranxhiska, Tatjana Lazarevski, Gjorgjieva, - Shkup
- Musai, B. (2003). Metodologjia e mësimdhënies. Tiranë ,CDE
- Burke,Ëalsh,Kate,Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI,Shkup,fq17
- Bardhyl Musai, Psikologji edukimi, PEGI, Tiranë ,1999
- Dimitris K. Mavroskoufis ,Mjediset e të mësuarit
- Bonnie Miller,Komunikimi me fëmijë,QPEA,2007
- Prof. Ass .Dr.Ibish Mazreku ,Metodologjia e hulumtimit shkencor
- ëëë.menaxherat.com
- ëëë.ëikipedia.org
- <https://dspace.aab-edu.net>
- Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI/ (autorë: Kate Burke Ëalsh, Suzana Kiranxhiska, Tatjana Lazarevski, Gjorgjieva), Shkup
- Musai Bardhyl, Metodologji e mësimdhënies,Tiranë, 2003
- Anderson,C,M, & Spaulding,S.A, Using positive behavior support to design effective classrooms, Chicago ,2007

Zbatimi i projekteve të komunave të Kosovës përmes financimit nga huamarrja dhe rritja e borgjit publik

Prof. ass. dr. Brikenda Vokshi, brikenda.vokshi@kolegjbiznesi.com

Prof. ass. dr. Ariana Xhemajli, ariana.xhemajli@kolegjbiznesi.com

ABSTRAKT

Në përgjithësi borxhi publik në Kosovë është duke shënuar rritje nga viti në vit, mirëpo komunat e Kosovës nga paslufta e deri më tani kanë shkallë shumë të vogël të borxhit publik, dhe atë kryesisht në formë të garancisë nga Qeveria e Kosovës.

Ky punim shkencor prezanton nivelin apo shkallën e borxhit në financimin e projekteve apo të buxhetit të komunave të Kosovës.

Menaxherët e borxhit duhet të sigurojnë që autoritetet fiskale janë të vetëdijshme për ndikimin e kërkesave të financimit të qeverive komunale dhe nivelet e borxhit në kostot e huamarrjes.

Borxhi Komunal apo Borxhi, është obligim ose detyrim monetar i krijuar me marrëveshje financimi, dëftesë thesari, instrument borxhi i pagarrantuar, obligacion, mbitërheqje ose emetim i letrave me vlerë dhe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj, përfshinë garanci.

Në këtë punim do të trajtohet koncepti dhe llojet e borxhit publik, borxhi komunal në veçanti, pastaj kufizimet e borxhit publik sipas legjislacionit në Kosovë, garancitë shtetërore, kriteret për marrjen e borxhit publik nga ana e komunave në Kosovë dhe në fund do të prezantohen konstatimet dhe rekomandimet e dhëna si rezultat i hulumtimit të bërë.

Fjalët kyqe: *Borxhi publik, Financim, Menaxhim, Qeveria, Komunal*

HYRJE

Në Republikën e Kosovës, Qeveria e bën menaxhimin e borxheve shtetërore, ku për këtë e ka nxjerrë edhe bazën ligjore, si në nivel primar ashtu edhe në atë sekondar, të cilat hartohen varësisht prej politikave të Qeverisë. Borxhi si instrument të cilin e përdor shteti për plotësimin e nevojave të veta të jashtëzakonshme dhe financimin e projekteve investuese të ndryshme, e zënë një vend të rëndësishëm pothuajse në të gjitha vendet në zhvillim dhe vendet e pazhvilluara, sidomos pas daljes nga lufta, në raste të katastrofave natyrore, krizave financiare etj. Borxhet publike mund të merren nga subjektet juridike apo fizike brenda shtetit si dhe nga ato jashtë shtetit.

Institucionet financiare apo kreditorët e mundshëm, në të cilat Kosova ka qasje për financim, të ndara sipas llojit të financimit, janë si në vijim:

➤ **Financim i Buxhetit**

- Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN),
- Banka Botërore (instrument i kushtëzuar me arritjen e reformave të caktuara)

➤ **Financim i Projekteve**

- Banka Botërore – Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH),
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH),
- Banka Evropiane Investuese (BEI),
- Agjencia Gjermane për Rindërtim (KfW),
- Republika Federale e Austrisë,
- Banka Islamike për Zhvillim (ISDB),
- Fondi Saudit për Zhvillim (SFD),
- Fondi i OPEC për Zhvillim (OFID),
- Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)
- Këshilli i Bankës Zhvillimore Europiane (CEB)
- Kreditues të tjerë me të cilët mund të krijohet bashkëpunim në të ardhmen.

METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij punimi shkencor janë përdorur disa metoda të kërkimit dhe hulumtimit shkencorë. Ndër metodat, e para është metoda empirike sipas të cilës është studiuar gjeneza e borxhit publike nga klasikët dhe borxhezët të cilët ndër të parët i kishin dhënë idetë e tyre mbi huanë publike. Pastaj metoda e analizës dhe sintezës duke bërë analizën e borxhit komunal në veçanti dhe borxhit public në përgjithësi ³⁴. Metodë tjetër e cila është përdorur është metoda e specializimit pasi që punimi trajton në specifika borxhin komunal. Mirëpo për t'i dhënë karakter në kuptim të plotë këtij punimi shkencor janë zhvilluar takime dhe intervista me akterët kryesore të kësaj lëmie në Kosovë, në radhë të parë me Njësinë Për Menaxhimin e Borxheve në kuadër të Thesarit, Ministria e Financave të Kosovës, pastaj me zyrtarë të ndryshëm financiar në disa komuna të Kosovës.

DEFINICIONI I BORXHIT PUBLIK

Definicioni i borxhit publike sipas Ligjit për Borxhet Publike të Kosovës Nr.03/L – 175, borxhi është çdo obligim financiar për tu paguar, apo përndryshe për të paguar para që dalin nga Kontratat për Financim, dëftesat e thesarit, obligacionet, mbitërheqjet apo nga letrat tjera me vlerë të transmetuara si këmbim për derdhjen e fondeve, si dhe obligimin për të paguar kryegjënë, interesin, zbritjen, provizionet, komisione apo gjobat të cilës do natyrë.

³⁴ Prof.Dr. Ali Jakupi, Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore, Prishtinë, 2005.

Borxhi shtetëror nënkupton çfarë do detyrimi financiar në të cilin ka hyrë Qeveria që përfshin borxhet e brendshme, borxhet e jashtme qofshin ato të emetuara në formë fizike apo elektronike³⁵. Pra, borxhi shtetëror është para të cilën shteti e merr nga subjektet, entitetet apo shtetet e huaja dhe të cilën duhet ta kthejë në kohën e caktuar me marrëveshje së bashku me interesin apo kamatën. Borxhi shtetëror merret për arsye të ndryshme, e ndër to janë :

- mbulimi i shpenzimeve të jashtëzakonshme
- mos-mbledhja me kohë e të hyrave publike në raport me shpenzimet publike
- financimi i projekteve investuese të ndryshme
- financimi i deficitit buxhetor

Varësisht nga kohëzgjatja e kthimit të borxhit, borxhi shtetëror ndahet në:

Borxh afatshkurtër, i cili duhet të kthehet apo paguhet në një periudhë kohore brenda një viti, dhe Borxh afatgjatë, i cili borxh duhet të paguhet në një periudhë më të gjatë se një vit.

Ndërsa, varësisht prej subjekteve apo entiteteve brenda territorit të shtetit apo nga organizatat, institucionet apo qeveritë e huaja, borxhi publik ndahet në:

- Borxh të brendshëm dhe
- Borxh të jashtëm (ndërkombëtar)

BORXHI PUBLIK I NËN-HUAZUAR

Borxhi i nën-huazuar karakterizohet nga 2 procese si në vijim³⁶:

- Procesi i parë është kur Qeveria huazon borxh nga kreditorët e jashtëm;
- Procesi i dytë është kur Qeveria i nën-huazon fondet e marra të borxhit tek organizatat e sektorit publik.

Në këto raste së pari e nënshkruan marrëveshjen e financimit me kreditorin, dhe së dyti hyn në marrëveshje nën-huazuese me organizatën e sektorit publik. Shlyerja e borxhit nga organizata buxhetore i bëhet Qeverisë, pastaj Qeveria ia transferon shumën e borxhit kreditorit të jashtëm apo të brendshëm.

Tabela 1. Niveli i borxhit të nën-huazuar 2014- TM4 2018

	2014	2015	2016	2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018
Borxhi Ndërkombëtar	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98	418.37	416.59	416.15
Qeveria Qendrore	316.54	339.87	323.93	365.18	358.55	364.03	361.85	364.53
Borxhi i Nën-huazuar	9.81	31.30	49.83	56.97	57.43	54.34	54.74	51.62
<i>Borxhi Ndërkombëtar (% e BPV-së) R</i>	5.86%	6.39%	6.25%	6.58%	6.26%	6.30%	6.27%	6.27%

³⁵ MEF, Udhëzimi Administrativ Nr.10/2010, Për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore dhe Garancive Shtetërore, Neni 2, Kosovë.

³⁶ Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, Strategjia Vjetore e Borxhit 2013,

BORXHI KOMUNAL

Komunat si organizata të sektorit publik, mund të hyjnë në borxh për plotësimin e nevojave financiare të tyre.

Sipas Ligjit për Borxhet Publike, në Kosovë, komunat mund të hyjnë në marrëveshje për borxhe afatshkurta dhe afatgjata, mirëpo duhet plotësuar disa kriterë. Njëri ndër këto kriterë është opinionimi pa rezervë apo i pa kualifikuar³⁷, nga auditori i përgjithshëm si pjesë e auditimeve vjetore ligjore të obliguara, për dy vitet e fundit radhazi.

Komuna e cila ka dështuar të kryejë pagesën e borxhit nuk mund të hyjë në ndonjë borxh shtesë për një periudhë prej dy viteve pasi të ketë bërë pagesën e atij borxhi të papaguar në mënyrë që të mos ketë mbetur asnjë pjesë e pa përmbushur.

Komuna nuk mund të hyjë në ndonjë borxh afatgjatë për një periudhë prej gjashtë muajve para zgjedhjeve komunale.

Shlyerja e borxhit komunal, në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara, është përgjegjësi vetëm e komunës, përveç kur garantohet shprehimisht nga një person tjetër juridik.

Kufizimi i borxhit

Në Kosovë, sipas Ligjit Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind (40 %) të Bruto Prodhimit Vendor (BPV). Në rast se Borxhi i Përgjithshëm e tejkalon dyzet për qind (40 %) të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), Qeveria duhet t'i paraqesë Kuvendit strategjinë për të kthyer borxhin e përgjithshëm nën pragun dyzet për qind (40 %) brenda një viti.

Ndërsa sipas këtij ligji, kufizimet e borxhit komunal janë:

- Stoku i përgjithshëm i borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë duke përfshirë garancitë, në asnjë moment nuk guxon ta tejkalojë dyzetë përqindëshin (40 %) e të hyrave vetanake të grumbulluara dhe granteve të përgjithshme (me përjashtim të atyre të hyrave që nuk janë rrjedhëse) për vitin fiskal që menjëherë i paraprinë marrjes së borxhit.
- Te borxhi afatshkurtër në asnjë rast nuk mund të tejkalojë më shumë se pesë për qind (5 %) e të hyrave të përgjithshme të grumbulluara (me përjashtim të atyre të hyrave që nuk janë rrjedhëse) për vitin fiskal që i paraprinë menjëherë marrjes së borxhit afatshkurtër.
- Te borxhi afatgjatë shuma e shërbimit të borxhit që duhet paguar në cilin do vit të një borxhi afatgjatë nuk duhet të tejkalojë dhjetë për qind (10 %) të të hyrave të përgjithshme të grumbulluara (me përjashtim të të hyrave që nuk janë rrjedhëse) për vitin fiskal që menjëherë i paraprinë marrjes së borxhit afatgjatë.

Financimi i projekteve të komunave të Kosovës, përmes borxhit publik

Janë borxhe në të cilat hynë shteti për financimin e projekteve të ndryshme kapitale investuese. Ministria e Financave duhet t'i analizojë mirë secilin propozim për financim të ndonjë projekti. Për këtë duhet themeluar një grup punues, i cili do t'i shqyrtojë të gjitha projektet për marrjen e borxhit

³⁷ Opinion i pakualifikuar, është kur Auditori i Jashtëm është i kënaqur në të gjitha aspektet material që kanë të bëjnë me pasqyrat financiare.

Të gjitha organizatat buxhetore të sektorit publik, kanë të drejtë të kërkojnë borxhe për financimin e ndonjë projekti investues. Andaj çdo propozim për projekte investuese, duhet t'i dorëzohet Ministrisë së Financave, e cila pastaj e formon një grup punues, ku në mesin e këtij grupi duhet të jetë edhe një përfaqësues i organizatës përkatëse e cila ka kërkuar financim për ndonjë projekt, si dhe një përfaqësues i huadhënësit. Pas vlerësimit të propozimit të projektit të caktuar, grupi punues e rekomandon Ministrinë e Financave, për aprovimin apo jo, të borxhit shtetëror.

Me rastin e aprovimit të borxhit ndaj organizatave tjera, Ministria e Financave kërkon nga organizatat e sektorit publik që të garantojnë se:

- Fondet e kërkuara duhet të shfrytëzohen vetëm për projektin e kërkuar,
- Ministria e Financave ka qasje në regjistrat apo shënimet që kanë të bëjnë me borxhin shtetëror.

GARANCIA SHTETËRORE

Garancia është një detyrim i mundshëm për të paguar borxhin që fillimisht del si detyrim i një pale të tretë dhe që varet prej dështimit të kësaj pale të tretë për të bërë pagesën në afatin e caktuar apo që t'i bindet kushteve të instrumentit me të cilin rregullohet një borxh i tillë burimor³⁸. Të gjitha Garancitë në të cilat futet shteti apo komuna, duhet të ceken në mënyrë eksplicite me shkrim.

Garancia shtetërore është një detyrim i mundshëm i Republikës së Kosovës i cili varet nga obligimet financiare të një personi tjetër juridik dhe bëhet pjesë e Borxhit Shtetëror kur pala e cila ka përgjegjësinë për pagesën e obligimeve të tilla financiare, dështon në kryerjen e pagesës në kohën e duhur. Pastaj, Qeveria e obligon Ministrinë e Financave si përgjegjëse të autorizuar për menaxhimin e borxheve shtetërore që ta merr përgjegjësinë për pagesën e borxhit të obliguesit kryesor / primar.

Garancitë shtetërore duhet të planifikohen në Ligjin vjetor të buxhetit të shtetit.

Garancitë shtetërore që i lëshohen entiteteve publike apo private do të përfshijnë kushtin që huamarrësi t'ia paguaj Qeverisë një tarifë të garancisë. Niveli i tarifës do të llogaritet në bazë të një analize të secilit aksion të garancisë nga pjesa e përgjithshme e humbjeve të supozuara nga portofoli e garancive. Tarifat e paguara nën skemën e tarifave të garancisë do të përfshihen në buxhet dhe do të llogariten si rezervë e garancisë. Vetëm shpenzimet që lidhen me humbjet e ndërlidhura me garancitë shtetërore mund të mbulohen nga kjo kategori e zotimeve. Çdo shumë e tejkaluar në zotimet e garancive në fund të vitit fiskal do të bartet në buxhetin e viteve të ardhshme nën të njëjtin titull të buxhetit të zotuar.

Huamarrësit të cilët mund të kenë të drejtë në garancinë shtetërore janë³⁹:

- organizatat e sektorit publik; ose
- entitetet private të cilat janë duke financuar projekte të infrastrukturës publike apo projekte të cilat janë të lidhura me sektorin ekonomik të rëndësisë strategjike apo sociale për shtetin.

Garancia shtetërore do të përfundojë atëherë kur⁴⁰:

- Huaja për të cilën është dhënë garancia është paguar e plotë nga huamarrësi;
- Afatet e Garancisë kanë skaduar; apo

³⁸ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Neni 2, Prishtinë, 2010

³⁹ Dr.Nexhmije Berisha Vokshi, Kontabiliteti i Sektorit Publike, Prishtinë, 2013

⁴⁰ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Neni 24

- Pagesa është kryer në përputhshmëri të plotë me kushtet e garancisë.

Deri në fund të vitit 2017 portofoli i garancive shtetërore të Republikës e Kosovës përbëhej nga tri garanci shtetërore të emetuara.

Në vitin 2014, Ministria e Financave ka emetuar garancinë e parë shtetërore në shumën prej 10 milion €, me të cilën garanton FSDK-në (Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës) për linjën kreditore të ofruar nga BERZh. Kjo linjë kreditore ka shërbyer që FSDK të rrisë vlerën e depozitave të siguruar nga 2,000 në 3,000 € për depositor ⁴¹.

Ndërsa, garancinë e dytë ndërkombëtare Republika e Kosovës e ka emetuar gjatë vitit 2016, përmes së cilës e garanton ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e ofruar nga BERZh në vlerën 10 milion €.

Vlen të theksohet që kjo kredi është e garantuar në kuadër të institucioneve të Kosovës fillimisht, nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Me këtë kredi është paraparë avancimi i Trafikut Urban të Prishtinës.

Në fund të vitit 2016 Republika e Kosovës ka emetuar garancinë e tretë shtetërore në shumën 24 milion €, e cila i është vënë në dispozicion FSDKsë për linjën e dytë kreditore të ofruar nga BERZh. Kjo linjë kreditore përbën vazhdimësi të linjës së parë kreditore që është vënë në dispozicion në vitin 2013, për mbulimin adekuat të depozituesve të siguruar në mënyrë proporcionale me rritjen graduale të përcaktuar me ligj të limitit të mbulesës për çdo depozitues.

Tabela 2. Struktura e borxhit të përgjithshëm dhe garancive shtetërore 2009-2017

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi Ndërkombëtar	249.01	260.08	253.71	336.60	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15
Borxhi i Brendshëm	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	249.01	260.08	253.71	409.92	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42
Garancitë Shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	10.00	10.00	20.00	44.00
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së)*	6.12	5.91	5.27	8.10	8.94	10.65	13.07	14.58	16.63
BPV	4,070	4,402	4,815	5,059	5,327	5,567	5,807	5,985	6,257

Tabela 3. Paraqitja detale e garancive shtetërore

⁴¹ Thesari i Kosovës, Divizioni për Menaxhimin e Borxheve, Buletini Ekonomik, 2017, Prishtinë, 2018

	2014	2015	2016	2017
Garancitë Shtetërore	10.00	10.00	20.00	44.00
Garancia për Linjën Kreditore të FSDK	10.00	10.00	10.00	10.00
Garancia për Trafikun Urban Prishtinë	0	0	10.00	10.00
Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	0	0	0	24.00
Garancitë Shtetërore (% e BPV-së)	0.18%	0.17%	0.33%	0.70%

PROGRAMI I BORXHEVE

Programi i borxhit nënkupton planifikimin dhe politikat kombëtare për borxhin duke u bazuar në kornizën makroekonomike dhe fiskale. Qeveria është e obliguar që çdo vit, jo më vonë se data 31 dhjetor, apo deri në datën e fundit të vitit fiskal aty ku viti fiskal nuk përputhet me vitin kalendarik, ta përgatitë programin për borxhin shtetëror.

Në Republikën e Kosovës, përgjegjës për përgatitjen dhe ofrimin e programit të borxhit shtetëror është Ministria e Financave. Kjo ministri ka për detyrë ta përgatisë programin dhe strategjinë për menaxhimin e borxhit shtetëror. Pas përgatitjes së programit për borxhin shtetëror, ministria ia dërgon Qeverisë për aprovim pastaj Qeveria ia dërgon Kuvendit për informim.

Programi për Borxhin Shtetëror do të sigurojë që të mbulohen nevojat e huamarrjes me shpenzimet më të vogla të mundshme, me një nivel të arsyeshëm të rrezikut.

Programi për borxhin shtetëror, përfshinë por nuk kufizohet në informatat në vijim ⁴²:

- Deklaratën e qëllimeve të politikave të Qeverisë për borxhet;
- Strategjinë për Menaxhimin e Borxhit lidhur me atë se si Qeveria synon t'i arrijë qëllimet e saja me politikat për borxhin;
- Standardet dhe caqet duke përfshirë kufizimet specifike vjetore për borxhet për secilën kategori të Borxhit Ndërkombëtar dhe atij të Brendshëm;
- Borxhin Shtetëror historik dhe pjesën aktuale të papaguar dhe Garancitë Shtetërore;
- Pagesat e pritura mbi Garancitë;
- Shërbimin historik dhe aktual të borxhit për të gjithë Borxhin Shtetëror;
- Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të propozuara, duke përfshirë edhe qëllimet e borxheve të këtyra;
- Parashikimet e Shërbimit të Borxhit duke përfshirë edhe borxhet e propozuara për të ardhmen;
- Treguesit historik për qëndrueshmërinë e borxhit dhe analizat e qëndrueshmërisë së borxhit të parashikuar; dhe
- Rishikimi i ecurisë së viteve të mëparshme dhe çfarëdo ndryshimesh të propozuara në Strategjinë për Menaxhimin e Borxhit.

⁴²Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Neni 15, Prishtinë, 2010

Strategjia vjetore e borxhit ka për qëllim të përcaktojë një orientim në mënyrë që Qeveria t'i plotësojë nevojat e saj buxhetore, të menaxhojë borxhin dhe të zhvillojë tregun e brendshëm të letrave me vlerë. Objektivat e strategjisë vjetore të borxhit janë ⁴³:

- Përcaktimi i objektivave qeveritare të huazimit;
- Prezantimi i strukturës aktuale të borxhit;
- Vlerësimi i rrezikut;
- Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit;
- Plani i huazimit për vitin e ardhshëm;

Strategjia vjetore e borxhit ka për obligim të përcaktojë planin për borxhin i cili shkaktohet në emër të institucioneve të Qeverisë. Po ashtu duhet të përfshijë borxhin total, i cili përbëhet nga borxhi shtetëror dhe komunal si dhe garancitë nëse e ka lëshuar ndonjë Qeveria ⁴⁴.

REKOMANDIME

Inkurajojmë të gjitha komunat e Kosovës që të bëjnë analiza detale të projekteve të ndryshme investive dhe të aplikojnë për kredi (borxh publik) qoftë në nivel ndërkombëtar si dhe në atë kontraktual nga Qeveria e Kosovës.

Duke pasur parasysh mungesën e analizave të mirëfillta për projekte apo investime nga ana e komunave të Kosovës, të cilat do të ndikonin në zhvillim lokal, rekomandimi ynë është që komunat e Kosovës mos të fillojnë të marrin borxh publik në mënyrë direkte, por të vazhdohet me garanci shtetërore nga ana e Qeverisë siç është gjendja për momentin si dhe me borxhe të nën-huazuara.

Po ashtu Qeveria do të duhej të ndërmerre masa sa më të shpejta për investime në zhvillimin lokal përmes borxhit publik të brendshëm me anë të letrave me vlerë të Qeverisë dhe përmes Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Pra, fondet nga FKPK-ja të investohen në Kosovë, e jo në tregjet ndërkombëtare siç ka vazhduar deri tani.

⁴³ Strategjia Vjetore e Borxhit 2013, Miistria e Financave, Thesari

⁴⁴ Dr. Nexhmije Berisha Vokshi, Kontabiliteti i Sektorit Publik, Prishtinë, 2013

LITERATURA

- [1] Ali J. (2005) “Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore”, Prishtinë, Kosovë ;
- [2] Ministria e Financave – Thesari (2011), “MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLI”, botim në bashkëpunim me Komisionin Evropian;
- [3] Kuvendi i Kosovës (2008), “LIGJI PËR MENAXHIMIN E FINANCave DHE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, NR. 03/L-048”, Prishtinë, Kosovë;
- [4] Kuvendi i Kosovës (2010), Ligji Nr.03/L-175 “Për Borxhet Publike” Prishtinë;
- [5] Nexhmije B.V. (2013) “Kontabiliteti i Sektorit Publik”, Prishtinë;
- [6] Thesari i Kosovës (2018), Divizioni për Menaxhimin e Borxheve “Buletini Ekonomik, 2017”, Prishtinë;
- [7] International Monetary Fund (2014) “Government Finance Statistics Manual 2014”;
- [8] Thesari i Kosovës (2018) “Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021”, Prishtinë.

KONCEPTI I JETËS DHE I SIGURISË SË NJERIUT SIPAS KARTËS SË MEDINËS

Dr. Taxhedin Bislimi

Karta e Medines⁴⁵ në vete përmban shumë nga vlerat dhe parimet e larta njerëzore, e cila kujdeset për të drejtat e personale dhe ato të përgjithshme, parime këto përmes së cilave antarët e një vendi ndjehen sikur të ishin një familje.

Ajo ishte një lëvizjeje reformatore, çlirim nga errësirat e padrejtësive, siç ishte skllavrizmi, në atë periudhë zhvlerësoheshin vlerat njerëzore, të fortët bënë shtypje dhe padrejtësi mbi të dobëtit, krenoheshin në bazë të prejardhjes, nuk dinin e as nuk respektonin ndonjë ligjë apo parim, kudo derdhej gjaku. Në këtë kartë⁴⁶ i Dërguari i Allahut a.s. njeriut ia sqaroi të drejtat e tij, nga të cilat, apo nga ndonjëra prej tyre ai nuk guxon të hjek dorë, sepse, ato janë të detyrueshme për njerëzin, pa të cilat nuk ka jetë.

Natyrisht karta e medines konsiderohet kushtetutë, e cila është venduar me rastin e themelimit të shtetit islam në Medine, ndërsa kushtetutat nuk merren me çështjet ligjore të degëzuara dhe në detaje, porse kushtetuta merret me parimet e përgjithshme, kurse ligjet e ndryshme të daluara në përputhshmëri me atë, bëjnë rregulimin dhe sistematizimin e çështjeve në detale. Marrë parasysh se kjo kartë konsiderohet kushtetutë, fletë për të drejtat dhe obligimet në përgjithësi, të drejtat dhe obligimet nuk i ka shënuar në detaje, edhe atë, ose, përshkak të volumit të vogël të kartës, ose marrë parasysh se çdo shprehje dhe vepër e Pejgamberit a.s. konsiderohet ligjëvënësi, apo thënë më mirë, fjalët dhe veprat e Pejgamberit a.s. janë tekst prej teksteve të ligjëvënësisë hyjnore (ligjë i Allahutxh.sh.), i cili është publikuar dhe komunikuar përmes të Dërguarit të Tij Muhamedit a.s.. Andaj kjo kartë është një nga ato tekste, por shikuar në vlerën e saj në jetën shoqërore dhe politike në shtetin e ri islam, kjo është e ndryshme nga tekstet tjera, sepse, kjo është një tekst i veçantë, nga fakti se kjo nuk ka të bëjë vetëm me muslimanët, duke pasur parasysh të Dërguarin e Allahut s.a. si udhëheqës fetarë vetëm për muslimanët, por kjo ka të bëjë me udhëheqësin si kryetar shteti,

⁴⁵ Këjo marrëveshje, respektivisht, ky dokument në literaturën dhe historinë islame emërohet me disa emra, ndër to; “Es-Sahife- letër,akt”, ky emërtim është bazuar se në disa nene kjo marrëveshje është përshkruar dhe emruar me këtë emër, ky është emri më i njohur dhe i përhapur në mesin e historianëve. “El-Kitab- libër,shkres”, shumë dijetarë dhe historian islam e kanë emruar me këtë emër. “El-Vethika- dokument, kartë”, me këtë emër ky dokument është njohur në periudhën më të vonshëm dhe te dijetarët e periudhës bashkëkohore. “Ed-Destur - kushtetutë”, shumë dijetarë bashkëkohorë e emrojnë me këtë emër.

⁴⁶ Në lidhje me datën dhe historikun e shkrimit dhe redaktimit të këtij dokumenti dijetarët islam kanë kundërthënë dhe disa mendime. A. kjo marrëveshje në esencë është një dokument, e cila është shkruar në vitin e parë prej hixhretit, para luftës së Bedrit. B. Kjo marrëveshje në esencë përbëhet prej dy dokumenteve, njëri është shkruar para luftës së Bedrit, kurse tjetëri pas luftës së Bedrit. C. Në esencë kjo përbëhet prej disa dokumenteve, por më vonë të gjitha ata janë bashkuar dhe bashkangjitur në një dokument. Sipas studiusve të kësaj karte, mendimi i parë është më i saktë, që do të thotë se, kjo është një dokument dhe është shkruar para luftës së Bedrit (shih, Es-Sulejman, Sulejman, Hukukul insani fi vethikatil medine, 59-75).

andaj, karta rregullon marrëdhëniet mes muslimanëve dhe jomuslimanëve, dispozitat e saj vlejn dhe aplikohen edhe mbi jomuslimanët.

Të përmendim se ky dokument për bazë dhe burim ka tekstet e jurispruedcës islame, tekste këto të cilan në brendin e tyre përfshijën shumë të drejta. Në këtë punim do të përqëndrohemi në lidhje me të drejtën e jetës dhe të drejtën e sigurisë sipas kësaj karte.

1. E drejta e jetës

1.1. E drejta e jetës në legjislacionin (kodin) islam

E drejta e jetës është e drejtë e parë dhe esenciale, me këtë të drejtë fillojnë të gjitha të drejtat tjera. Në ekzistimin e kësaj aplikohen të drejtat tjera, në mos ekzistimin dhe mbarimin e saj nuk ekziston asnjë e drejtë tjetër. Në shikim të parë vërehet se, e drejta e jetës është e drejtë e njeriut, por në të vërtetë kjo është dhuratë nga Allahu xh.sh. të cilën ia ka dhuruar njeriut, njeriu nuk ka ndonjë merit për ekzistimin e jetës, andaj, sipas parimeve islame, çdo atakë dhe sulm mbi te llogaritet krim⁴⁷.

E drejta e jetës është e garantuar për çdo njeri, andaj në bazë të kësaj dalin shumë dispozita, ndër ato është se:

1-Ndalohet mbytja e njeriut. Çdo lloj padrejtësie, tiranie, shtypje, sulmi dhe ataku ndaj njeriut është rreptësisht i ndaluar, përveç në raste të veçanta dhe të kufizuara edhe atë për shkaqe të caktuara, jashtë asaj e drejta e jetës është e garantuar dhe e shenjtë, këtë e vërtetojnë argumentet tekstuale të prera dhe decite të jurispruedcës islame⁴⁸. Për shkak se jeta është dhuratë nga Allahu xh.sh. dhe se Ai është i vetmi që jepë dhe e mer jetën. Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe mos e mbytni njëriun sepse mbytjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë”. Surja, El en’amë, 151.

“Edhe ata që pos Allahut, nuk lusin ndonjë zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar Allahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë”. Surja, El Furkanë, 68

2-Ndalohet vetëvrasja. Jeta nuk është e drejtë e pronarit të saj, sepse ajo në të vërtetë është dhuratë nga Allahu xh.sh. kurse shpirti është emanet në dorën pronarit të tij, andaj në asnjë mënyrë nuk lejohet ataku dhe sulmi mbi këtë të drejtë, prandaj, vetëvrasja llogaritet krim i shëmtuar. Vetëvrasësi për krimin e bërë ndaj jetës së vet, në këtë botë nuk mund të merr dënimin e merituar, porse ai për krimin e bërë në botën tjetër do të dënohet me dënim të ashpër. Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe mos mbytni veten tuaj. Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm për ju. Kush bën këtë (që ndaloi Zoti) qëllimisht dhe tejkalon kufijtë, Ne do ta hudhim atë në një zjarr të fortë. Dhe kjo është lehtë për Allahun”, Surja, En Nisaë, 29-30.

⁴⁷ Ez-Zuhajli, Muhamed, Hukukul insan fil islam, fq, 138.

⁴⁸ Es-Sibai, Mustafa, fq, 61.

3-Ndalohet dhënia leje për mbytje. Kjo është si pasoj që del nga ndalimi i vetëvrasjes. Për këtë çështje të gjithë dijetarët janë unanim. Edhe ai që lejon edhe atij që li lejohet që të dytë janë të barabart në mëkatë dhe krim, nga fakti se, në këtë të drejtë askush nuk posedon të drejtë, përveç Allahut xh.sh. i Cili dhuronë dhe merr jetën.

4-Ndalohet mbytja e fetusit (fëmiun në barkun e nësës së tij). Andaj, abortimi i fëmijës pasi që t'i vie shpirti është i ndaluar. Allahu xh.sh. thotë:

“Ju mos mbyrni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkt i madh”. Surja, El Israë,31.

5-Lejimi i të vepruarit të sendeve të ndaluara, me qëllim ruajtjes së jetës. Sipas jurisprudencës islame njeriu duhet të hanë dhe pinë (të konsumojë) dhe të përdorë ilaçe të ndryshme, me qëllim ruajtjes së jetës, në të kundërtën konsiderohet se ai vetveten e ka hedhur në shkatërrim. Në anën tjetër nëse, njeriut i kanoset reziku për jetë, atij i lejohet të përdor dhe të konsumonë edhe sendet e ndaluar, siç është mishi i kafshës së ngordhur, mishi i derrit, pijet alkoolike etj.

6-Ndera dhe dinjiteti njerëzor. E drejta e jetës ndërlidhet edhe me dinjitetin njerëzor, andaj askujt nuk i lejohet që të adhuroj ndonjë njeri tjetër, dikush të ndiej veten se është i adhuruar (zot) kurse tjetri adhures (rob) i tij, adhurimi i takon vetëm krijesit të gjithësisë Allahut xh.sh.. Allahu xh.sh. thotë:

“Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam”. Surja, El Israë, 70.

Allahu xh.sh. çdo send që gjendet në tokë dhe qiellëra e bëri në shërbim të njeriut dhe të gjitha ato ia nënshtroi atij, e nderoi me dërgimin e Pejgamberëve a.s., për të zbriti libratë (kitabët), ia mësoi dispozitat e jurisprudencës për mes së cilave ai lartësohet në piedestalin më të lartë dhe kështu e nderoi dhe e lartësoi nga të gjitha krijesat tjera. Nderën dhe dinjitetin njerëzorë e vërtetojnë edhe hadithet dhe veprat e Të Dërguarit të Allahut s.a., në një rast kur pran Tij kishte kaluar një xhenaze (kufomë), Pejgamberi a.s ishte ngritur në këmbë, kjo është xhenaze e një jehudi (hebreu), i thanë të pranishmit; “A nuk është njeri”, ju përgjith Pejgamberi a.s. atyre⁴⁹.

7-Ndalohet shfarosja, zhdukja dhe shkatërrimi i tërë njerëzisë ose pjesërisht. Siç është rasti kur mes popujëve dhe shteteve, apo, mes aleancave dhe bloqeve ndodhë mosmarrëveshje, luftëra të armatosura dhe konfrontime ushtarake, ku secila palë tenton që tjetërën ta shfaros tërësisht, kjo është e ndaluar sipas jurisprudencës islame.

8-Ndera dhe dinjiteti i të vdekurit. Islami njeriun e nderoi edhe për së gjalli por edhe pas vdekjes së tij, nderën dhe rrespektin e të vdekurit jurisprudenca islame e konsideroi obligim, ligjëvënësi islam obligoi të afrëmit, shoqërin dhe shtetin që të mbrojnë kufomën (xhenazen) e të vdekurit, ta varrosin në bazë të dispozitave të shariatit islam, ndaloj nënçmimin dhe zhvlerësimin e të vdekurit.

⁴⁹ Transmeton Imam Buhariu në sahihun e tij, nr, i hadithit, 1312. Imam Muslimi në sahihun e tij, nr, i hadithit 961.

Ndaloi të masakrohet trupi i të vdekurit apo të vrrarit në betej, edhe nëse është prej anës së kundërshtarit dhe anmikut. Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Thyerja e ashtit të të vdekurit, është ngjashëm sikur t’i thyesh derisa ishte i gjall”.*⁵⁰

*“Mos e zbulo (zhvesh) kofshën tënde, dhe mos shiko në kofshën e të gjallit e as në të vdekurit”.*⁵¹

Kështu islami urdhëroi që i vdekuri për në botën tjetër të përcillet me respekt dhe me nder. Madje, nuk lejohet as ulja mbi varrin e njeriut të vdekur, Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Sikur ndonjëri prej jush të ulet mbi ndonjë prush, dhe t’ia djeg rrobat e tij, dhe kështu do të arrij deri në lëkurën e tij, kjo më mirë do të ishte për te, se sa të ulet mbi varr”.*⁵²

1.2. E drejta e jetës sipas kartës së Medines

Karta e Medines ka përfshi të drejtën e jetës për të gjithë bashkëatëdhetarët (qytetarët) e shtetit islam. Kjo e drejtë në mënyrë të drejtëpërdrejtë kuptohet nga neni 21, *“Nëse dikush e vret besimtarin pa ndonjë bazë dhe pa arsye, mbi te do të aplikohet ligji i hakmerrjes, përceç nëse familja e të vrrarit ia fal atij. Përndryshe, të gjithë besimtarët do të ngriten kundër tij dhe janë të detyruar ta sulmojnë”.*

Po ashtu karta ka përfshi të drejtën për jetë edhe në disa nene tjera edhe atë ose në mënyrë direkte ose tërthorazi (në mënyrë indirekte), siç janë nenet⁵³:

Neni 14, *“Besimtari nuk guxon ta vrasë besimtarin tjetër për shkak të jobesimtarit, e as ta përkrahë jo besimtarin kundër besimtarit”.*

Neni, 16, *“Hebrejtë, të cilët lidhen me ne, fitojnë të drejtën e ndihmës dhe përkrahjes sonë, askush nuk do t’i shtypë e as do t’i ndihmojë armiqëtë e tyre”.*

Neni 25, *“Hebrejtë e fisit Benu Avf formojnë një bashkësi me besimtarët. Ata ndjekin fenë e tyre, kurse muslimanët të veten, qofshinë vetë ata apo miqtë e tyre, përveç atij i cili bën krime dhe mëkat, ai dëmton vetëm veten dhe familjen e tij”.*

Neni 40, *“Fqinji është si vetë personi, nuk guxon t’i bëhet atij asnjë dëm as mëkat”.*

⁵⁰ Transmeton, Ibni maxheh, Ebu Davud dhe Imam Ahmedi.

⁵¹ Transmeton, Ebu davudi, Ibni Maxheh dhe Imam Ahmedi.

⁵² Transmeton, Muslimi dhe Imam Ahmedi.

⁵³ Kjo kartë paraqitet në versione prej 47, 52 ose 70 neneve. Në këtë punum jemi bazuar në versionin i cili është prej 47 neneve, pasë të cilit qëndrojnë shumica e studiusve, në mesin e tyre është Dr, Muhamed Hamidullah. Ky transmetim është transmetimi më i sakët, të cilin e shënon Muhamed ibni Is’haku (Siret ibni Hisham).

1.3. E drejta e jetës në kartat (konventat) ndërkombëtare

Kjo e drejtë gjatë historisë ishte prekur me të meta dhe defekte, më herët në periudha të ndryshme disa ligje lejonin mbytjen e robve. Kishte edhe aso ligje ku kryefamiljari, prijësi i fisit, dhe mbreti posedonin të drejtën e jetës mbi personat të cilët ishin nën mbikqyrjen e tij. Në periudhën para islame (në xhahilije) tek arabët prindi kishte të drejtë të mbys vajzën e tij (ta varros për së gjalli).

Më pas qarqet dhe kartat bashkëkohore njeriut ia vërtetuan të drejtën e jetës. Këtë të drejtë ia vërtetoi Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin tre (3) *“Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake”*.

Po ashtu Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike neni i gjashtë (6), alinea një (1), *“E drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta”*.

1.4. Krahasim mes kartës së Medines dhe kartave tjera ndërkombëtare

Në bazë të kësaj që shënuam më parë, mund të konkludojmë se, në disa segmente këto karta janë të përbashkëta, por me disa tjera dallohet karta e Medines;

-Parimisht kartat ndërkombëtare pajtohen me atë të Medines, sepse, të gjitha e vërtetojnë të drejtën e njeriut për jetë.

-Ndërsa, e drejta e jetës në islam dallon nga marrëveshjet dhe kartat tjera në disa çështje, ndër to;

a. Jeta në vizionin islam është dhuratë prej Allahut xh.sh., kështu është te të gjithë fetë, andaj vlera juridike e saj është shumë e lartë, ajo është e drejtë e shenjët dhe e denjë, duhet mbrojtur maksimalisht, ashtu që të arrihet qëllimi i kësaj dhurate. Kjo vlerë dhe kjo mbrojtje bazohet në shumë argumente tekstuale të jurisprudencës islame, në mesin e tyre është ky hadith i Pejgamberit a.s.

“Çdo musliman e ka të ndaluar gjakun, pasurinë dhe nderin e muslimanit”.⁵⁴

b.Sheriati islam ndalon mbytjen e fetusit dhe shfarosjen e tërë njerëzisë, për faktin se jeta është dhuratë e Allahut xh.sh.

c.Islami njeriun e nderoi edhe për së gjalli por edhe pas vdekjes së tij.

⁵⁴ Transmeton, Muslimi (ky hadith është pjesë e hadithi nr, 2564).

2. E drejta e sigurisë

2.1. E drejta e sigurisë begati prej begative të Allahut xh.sh.

Siguria konsiderohet njëra nga begatit dhe nimetet më të mëdha të Allahut xh.sh., Allahu xh.sh. në Kur'ani Kerim ju drejtua Kurejshve për t'ua bërë me dije vlerën, begatin dhe rëndësinë e sigurisë.

“Po a nuk u siguruam Ne atyrenjë vend të shenjtë e të sigurt që aty sillen frutat e çdo sendi si furnizim nga ana Jonë, por shumica e tyre nuk dinë”. Surja, El Kasas, 57.

“Për hirë të garantimit që e gëzojnë kurejshtë. Garantimin e udhëtimit të tyre të lirë dimrit dhe verës. Pra, le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie. I cili i ushqen pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike”. Surja, Kurejs, 1-4.

Pejgamberi a.s. vlerën e sigurisë e kishte sqaruar në shumë hadithe, sa për ilustrim të shënojmë këtë hadith.

*“Kush gdhiret prej jush i sigurt në shpirtin (në veten) e tij (në familjen e tij), i shëndoshë në trupin e tij dhe ka ushqim për një ditë, është sikur t'i është dhënë krejt bota”.*⁵⁵

Vërtet siguria konsiderohet njëra nga shtyllat kryesore mbi të cilën shoqëria ndërton stabilitetin dhe përparimin. Ajo është boshti kryesor për zhvillim dhe stabilitet. Është klimë e përshtatshme për investim dhe prosperitet. Andaj, ajo është njëra nga të drejtat esenciale të njeriut, të cilës islami dhe karta e Medines i kushtoi rëndësi të veçantë.

2.2. E drejta e sigurisë në sipas kartës së Medines

Një ndër çështjet më me rëndësi që e shqetësonte shoqërinë e asaj kohe në Gadishullin Arab, para hixhretit dhe para shkrimit të kësaj karte, ishte mos ekzistimi i sigurisë në tërë Gadishullin Arab, ndër ato vende ishte edhe Mekka dhe Medineja. Dominonte gjakëmarrëja, në vend të shtetit dominonte sistemi fisnor. Me ardhjen e islamit kishte filluar të ndryshoj gjendja e përgjithëshme në ato vende dhe veçanërisht në Medine, Pejgamberi a.s. bëri pajtimin dhe vëllezërimin mes njerëzve, armiqësitë dhe mos marrëveshjet që kishim ata mes veti u zhdukën dhe në vend të tyre u përhap dhe u rrënjësua dashuria, respekti, siguria etj.

Shkrimi i këtij dokumenti nga ana e Pejgamberit a.s. ishte ndryshim i traditëve dhe ligjeve të cilat dominonin para shkrimit të kësaj karte. Andaj, siguria sipas kësaj karte është siç vijon:

-Ndalohej pa drejtësi, ndalohej ataku, tirania dhe shtypja ndaj të tjerëve. Neni 13, *“Të gjithë besimtarët e devotshëm patjetër duhet t'i kundërvihen tiranit ose atij, i cili është i gatshëm për të kryer padrejtësi e krime, i cili i shkel të drejtat apo fut hutin mes besimtarëve. Të gjithë bashkërisht le t'i kundërvihen atij, madje edhe nëse është djali i ndonjërit prej tyre!”*.

⁵⁵ Transmeton Tirmidhiu.

-Ndalohet strehimi i kriminelëve. Neni 22, *“Asnjë besimtari i cili ka pranuar atë që gjendet në këtë dokument dhe i cili beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit nuk i lejohet ta ndihmojë e as strehojë novatorin. Kush e ndihmon dhe strehon atë, mbi të bie mallkimi dhe hidhrimi i Allahut në Ditën e Gjykimit dhe nuk pranohet prej tijdëshpërblim e as pendim”*.

-Heqja e imunitetit (mbrojtjes) të kriminelëve. Parim ky i cili rrënjos dhe përforcon sigurinë, askush nuk gëzon të drejtën e imunitetit dhe të mbrojtjes, nëse ka kryer ndonjë krim i cili e prek sigurinë, ky parim qartë vërehet në nenin 47, *“Kush bën diçka jashtë kësaj, do t’i bartë vetë pasojat. Me të vërtetë, çdo gjë që është në këtë dokument Allahu e ka pranuar dhe miratuar, andaj kjo do të aplikohet edhe ndaj çdo shtypsi dhe krimineli. Kush dëshiron të dalë nga Medina është i sigurt, sikurse edhe ai që mbetet në të, përveç atij që bën ndonjë krim apo tirani. Me të vërtetë Allahu është me atë i cili është vepërmirë dhe i devotshëm, gjithashtu edhe i Dërguari i Tij, Muhamedia.s.”*.

-Ndalohet gjakmarrëja (hakmarrja) tradhtia dhe pabesia. Neni 36, *“Askujt nuk do t’i ndalohet të hakmerret për plagët e shkaktuara sepse kush e mbytët tjetrin, në fakt ai mbyt vetveten dhe familjen e tij, përceç atij të cilit i bëhet dhunë.Të gjitha këto Allahu m’i ka pranuar dhe miratuar”*.

Në fakt ky nen është vazhdimësi i nenit 13 dhe 21, të cilët flasin për ndalimin e padrejtësisë, tiranisë, degjenerimit, tradhëtisë mbytjes etj. Neni 36, përcakton dhe vendos se gjakmarrja (hakmarrja) aplikohet vetën në raste mbytje, nga fakti se gjaku i njeriut është i shtrejt dhe në asnjë mënyrë nuk goxon të derdhet padrejtësisht, i vetëmi që mund të derdh gjakun e njeriut dhe të aplikoj dënimin me vdekje është gjyqi edhe atë vetëm mbi dorërassin e jo mbi ndonjë antar tjetër të familjes së mbytësit.

-Përgjegjësia bie mbi vetë personin (dënimi aplikohet mbi kryerësin e veprës). Nga kjo kuptohet se dënimi aplikohet vetëm mbi atë që ka kryer krimin dhe nuk guxon të përfshij edhe persona tjerë të cilët nuk janë involvuar në atë krim, pavarësisht se kush jan ata dhe sa jan të afër me kryerësin e krimit. Këtë në mënyrë të qartë e përmend neni 25, *“përveç atij i cili bën krime dhe mëkat, ai dëmton vetëm veten dhe familjen e tij”*.

Neni 31, *“Përjashtim bën ai i cili krime dhe mëkat, ai dëmton vetëm vetën dhe familjen e tij”*.

Neni 36, *“Askujt nuk do t’i ndalohet të hakmerret për plagët e shkaktuara sepse kush e mbytët tjetrin, në fakt ai mbyt vetveten dhe familjen e tij, përceç atij të cilit i bëhet dhunë.Të gjitha këto Allahu m’i ka pranuar dhe miratuar”*.

Neni 37, *“Nuk do të dëmtohet përsone për shkak të aleatit të tij”*.

Neni 47, *“Ata janë të përbashkët në të mira, por jo në mëkate. Çdo veprues nuk vepronë vetëm kundër vetëvetës”*.

-Mbrojtja e shtetit (Mrdines) është përgjegjësi dhe obligim i përbashkët. Në periudhën kur migroi Pejgamberi a.s. në Medine, në Medine dhe gjithëandëj vlonin problemet, mosmarrëveshjet, luftërat, urrejtjet mes fiseve dhe popujve që jetonin në atë periudhë në ato vende, me theks të

veçantë në Medine. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje përkohësisht në një mënyrë këto probleme disi u eliminuar, ose, disi u zbutën. Kështu që Medinja u shndërrua në vend të sigurt për muslimanët, jehudët, idhujtarët dhe për të gjithë ata të cilën kërkonin strehim në Medine nga fiset që gjendeshin rreth medines e më largë, në te do të jetonin arab dhe jo arab. Që nënkupton se, për herë të parë shfaqet kuptimi i vendqëndrimit (vatanit, shtetit, ardhurisë) të përbashkët, ku të gjithë banuesit e tij do të jenë të barabartë pavarësisht prejardhjes, kombit, fesë etj. Kështu kjo kartë të gjithë i bashkoi pa dallim feje, dhe të gjithë i obligoi që ta mbrojnë prej armiqëve të jashtëm.

Për këtë çështje flasin disa nene. Neni 24, *“Hebrejtë duhet të ndajnë fonde së bashku me besimtarët, për atë kohë sa janë në luftë”*.

Neni 37, *“Hebrejtë në luftë do të marrin pjesë me pasuritë e tyre, edhe muslimanët me pasuritë e tyre. Ata do të ndihmohen mes tyre kundër atij i cili i lufton nënshkruesit e këtij dokumenti. Ata duhet të këshillohen mes tyre dhe të kenë marrëdhënie miqësore”*.

Neni 38, *“Hebrejtë do t’i mbulojnë shpenzimet e luftës, së bashku me muslimanët, derisajmë në luftë”*.

Neni 44, *“Dhe të gjithë do të ndihmojnë njëri-tjetrin kundër atyre që sulmojnë Jethribin (Medinen)”*.

-Masa sigurie preventive të veçanta (të jashtëzakonshme) për Kurjshët. Kurejshët në atë periudhë ishin armiqët e përbetuar të Pejgamberit a.s., kundër Pejgamberit a.s. dhe muslimanëve përdorën të gjitha mënyrat e shtypjes, dhunës, maltretimeve, persekutimeve etj, me qëllim që të mos përhapet feja islame, si pasojë e gjitha atyre Pejgamberi a.s. u detyrua të bëjë hixhret për në Medine. Karta e medines qartë shpalli se Kurjshët janë armiku i përbashkët i shtetit të ri në Medine, kështu që ndaloi çfardo mardhënie dhe bashkëpunimi me kurejshët. Neni 20/b *“Idhujtari nuk mund t’u ofrojë Kurejshve ndihmë materiale e as personale, as nuk bën të nxisë kundër besimtarëve”*.

Neni 43, *“Me Kurejshët dhe ndihmësit e tyre nuk do të ketë kurrfarë fqinjësie të mirë (mbrojtje dhe besnikëri –emanet) ”*. Marrë parasysh se kërcnimet nga ana e Kurejshëve kundër Medines sa vinin e shtoheshin, andaj ky dokument qartazi ua ndaloi të gjithë banorëve të Medines çdo bashkëpunimi, ua ndaloi fqinësinë e mirë dhe se për ata nuk ka kurrfarë bese e as mbrojtje, nga fakti se shteti i ri ishte në gjendje të jashtëzakonshme dhe bënte përgatitje për luftë, për këtë Pejgamberi a.s. i anuloi fqinësinë e mirë që ishte më parë mes Medines dhe Kurejshëve.

-Masa preventive për lëvizjen e banorëve të Medines. Ky shtet ishte ende i ri dhe në formim e sipër, andaj kishte nevojë për masa sigurie shitesë me qëllim vëzhgimin e gjendjes së sigurisë, për shkak të ndonjë rreziku ushtarak të mundshëm. Pejgamberi a.s. deshi të dij çdo lëvizje të jehudëve jo vetëm në aspektin ushtarak por edhe në atë tregëtar (ekonomik), masa këto të cilat ushtarakisht janë të patjetërsueshme dhe të cilat janë të njohura dhe normale në gjendje lufte dhe tek te të gjitha shtetet. Kështu është vepruar dhe vepohet me qëllim që të mos barten lajmet dhe të mos bëhet shpionim në dobi të anamikut. Prandaj, karta vërtetoi se çdo lëvizje e banorëve të Medines duhet të

jetë me dijen dhe lejen e Pejgamberit a.s.. Neni 36, *“Asnjë prej tyre nuk mund të dalë (prej Medines) përveç me leje të Muhamedit”*.

-Medinja është vend i shenjtë. Neni 39, *“I gjithë territori i Jethribit është i shenjtë (harem) dhe i pacenueshëm për të gjitha subjektet e këtij dokumenti”*.

Me këtë është për qëllim se Medinja është vend i shenjtë (harem) që nënkupton se brenda kufijëve të haremit nuk guxon të bëhet luftë apo ndonjë gjakderdhje tjetër, porse haremi duhet të jetë i sigurt. Kjo nuk vlen vetëm për muslimanët por kjo vlen për të gjithë ata të cilët janë bonor të këtij vendi, musliman, jehud, idhujtar etj. Me këtë nën garantohej siguria dhe ndalohej çdo lloj lufte mes banorëve të Medines.

2.3. E drejta e sigurisë sipas kartave (marrëveshjeve) ndërkombëtare

Atë që e kishte shënuar dokumenti i Medines në lidhje me të drejtën e jetës dhe sigurisë, të njejtë e ka vërtetua edhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin tre (3) *“Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake”*.

Kurse Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike neni 3, alinea1, *“Në kohën kur një rrezik publik i jashtëzakonshëm kërcënon ekzistencën e kombit dhe shpallet zyrtarisht si i tillë, shtetet palë të këtij Pakti mund të marrin masa me të cilat shmangen detyrimet e parashikuara në këtë Pakt, në vëllimin përpikërisht të caktuar sipas kërkesave të situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në mospërputhje me detyrimet e tyre të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të mos ngatërrojnë, si pasojë, një diskriminim të bazuar vetëm në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, ose origjinë shoqërore”*.

Po ashtu edhe neni 9 alinea 1, *“Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj”*.

Sa i përket masave për mbrojtjen e Medines që ajo të jetë e përbashkët dhe përgjegjësi kolektive të gjithë banorëve të Medines, një qëndrim të tillë shumë qarqe ndërkombëtare kanë ndjekur po të njejtë veprim. Kjo qartë vërehet në Konferencë e tretë të Kombeve të Bashkuara, me temën *“Parandalimi dhe pengimi i krimit dhe mënyrën e trajtimit të kriminelëve”*, e mbajtur në Stokholm në vitin 1965. Ku mes tjerash u diskutua edhe për rolin e masës (popullit), familjes dhe shkollës në mbrojtjen e krimit.

Kurse Konferenca e katërtë e Kombeve të Bashkuara e mbajtur në Kyoto në vitin 1970, në këtë konferencë, në pjesën e dytë u debatua në lidhje me këtë çështje, me temën: *“Pjesëmarrja e masës për pengimin e krimit dhe vënia kontrol mbi atë”*. Ku kjo konferencë vërtetoi rëndësinë e pjesëmarrjes së masës në luftën kundër krimit. E kjo përputhet me kartën e Medines, ku ajo masën e konsideroi si bazë esenciale për ruajtjen e sigurisë në Medine (në shtetin e ri në Medine).

Konkluzë

Në bazë të kësaj që u shënua më parë mund të konkludojmë se;

1.E drejta e jetës është e garantuar në fenë islame, këtë e vërtetojnë shumë argumente autentike nga Kur'ani Kerimi, sunneti, në mesin e shumë argumenteve tjera këtë të drejtë e vërteton edhe karta e Medines.

2.Këtë të drejtë e vërtetojnë edhe të gjitha ligjet pozitive dhe qarqet ndërkombëtare, por ajo çka dallon në fenë islame është se;

a. Jeta në vizionin islam është dhuratë prej Allahut xh.sh., andaj vlera juridike e saj është shumë e lartë, ajo është e drejtë e shenjë dhe e denjë, duhet mbrojtur maksimalisht, ashtu që të arrihet qëllimi i kësaj dhurate.

b.Sheriati islam ndalon mbytjen e fetusit dhe shfarosjen e tërë njerëzisë, për faktin se jeta është dhuratë e Allahut xh.sh.

c.Islami njeriun e nderoi edhe për së gjalli por edhe pas vdekjes së tij.

3.Po ashtu edhe e drejta e sigurisë është e garantuar me Kur'ani Kerim dhe me sunnetin e të Dërguarit të Allahut s.a. dhe me kartën e Medines.

4.Shoqëria e parë, respektivisht, shteti i parë të cilin e themeloi Pejgamberi a.s. në Medinen e Ndrirshme, ishte shtet në të cilin të gjithë banorët ishin të barabartë në të drejtat dhe obligimet e tyre.

Literatura

- Ibni Hisham, Es-Siretun nebevije, Daru ihjaut turathul arabij, Bejrur, Liban.
- Ibni Hisham, Biografia e Pejgamberit a.s. – version i shurtuar i përgatitur nga Abdus-salam Harun, përktheu nga arabishtja, Miftar Ajdini, LOGOS.A, Shkup, prishtinë, Tiranë, 2017.
- Ibni Kethir, Elbidaje ven nihaje, Mektebetul mearif, Bejrut, 1980.
- El-Buti, Dr, Muhamed Seid Ramadan, Fikhu sire, El-Matbaa xhedide, Damask, 1983-1984
- Es-Sulejman, Salih Sulejman, Hukukul insan fi vethikatil medinetil munevere, Daru xhamiatu naif lilneshr, Rijad, 2015m-1437h.
- El-Isavi, Xhasim Muhamed Rashid, El-Vethikatul en-nebevijeti vel ehkamush sheriatil mustefadeti minha, Daru sahabet, Sharika, Imaratete Bashkuara Arabe,
- El-Gamidi, Dr, Abdulatif ibni Seiid, Hukukul insani fil islami, Akademia Naif el-arabije lilulumil emnije, Rijad, 2000 m- 1421h.
- Ez-Zuhajli, Dr, Muhamed, Hukul insani fil islami, Daru Ibni kethir, Damask- Bejrut, 1429.
- El-Gazali, Muhamed, Fikhu sire, Daru daëve, Aleksandri (Egjipt), 1989m-1409h.
- El-Mubarkfuri, Safijurrahman, Er-Rehikul mehtum, Darul beshir, Tanta (Egjipt), 1994m-1415h.
- Hasan, Dr, Hasan Ibrahim, Tarihul islami, Daru ihjaut turathul arabij, Bejrut, 1964.
- Shasivari, Dr, Jeton, E drejta kushtetuese Libri I (Botimi i parë), Furkan ISM, Shkup.
- * <http://www.koleggi-juridica.org/>; [/www.fon.edu.mk](http://www.fon.edu.mk)) Editor-in-Chief, International Social Sciences Magazine "VISIONS" www.visionsmagazine.org; (nazmimaliqi@hotmail.com).

PËRDORIMI I ISTIHSANIT, dëshmi për lidhshkrimin e Ebu Hanifes në shkollën racionaliste

Dr. Taxhedin Bislimi

Hyrje

Para se të themi diçka rreth Istihsanit si burim i sheriatit islam, për përfitimin e dispozitave juridike islame në përgjithësi, e në shkollën juridike hanefite në veçanti, detyrimisht duhet të kemi një pasqyrë të qartë rreth legjislacionit islam, fazave të zhvillimit të sheriatit islam, burimeve mbi të cilat ndërtohet e drejta islame në përgjithësi, metodologjia shkencore që përdoret për përfitimin e dispozitave juridike islame, principet e përgjithshme shkencore dhe karakteristikat e përbashkëta dhe dalluese për çdo periudhë kohore, që prej ditëve të para të shpalljes e deri atëherë kur Istihsanit formohet si burimet e sheriatit Islam.

Në kontekst të kësaj në vazhdim, në pika shumë të shkurta do të paraqesim tri periudhat kryesore të zhvillimit të legjislacionit islam, që janë:

1. Legjislacioni (Sheriati) në periudhën e Pejgamberit a.s.

Gjatë kësaj periudhe vahji (shpallja) ishte i vetmi burim i legjislacionit islam. Vahji i zbriti Muhammedit a.s. përmes Xhibrilit, dhe atë, herë-herë nga një ajet, herë-herë më shumë ajete, e disa herë komplet një sure ashtu siç e kërkonte nevoja. Në këtë periudhë legjislacioni ishte në themelim e sipër, qoftë në gjërat e ndaluara apo ato të obligueshme. Në këtë kohë, legjislacioni drejtpërdrejt ishte i mbështetur në Kur'an, gjithashtu në Sunnetin e Pejgamberit a.s., i cili ishte sqarues i Kur'anit e që për këtë Allahu xh.sh thotë:

“Me argumente e me libra të shenjtë. Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)”.⁵⁶

2. Periudha e sahabëve

Në kohën e Pejgamberit a.s., sahabët i merrnin dispozitat e Sheriatit drejtpërdrejt nga i Dërguari i Allahut xh.sh., por në rastet kur ata nuk gjendeshin në praninë e Pejgamberit a.s. dhe nuk kishin njohuri për ndonjë dispozitë, ata bënë ixhtihad dhe jepnin kontributin e tyre maksimal për të përfituar hukmin e ngjarjes që u ndodhte atyre. Pejgamberi a.s. i nxiste shokët e tij për të bërë ixhtihad dhe u thoshte:

⁵⁶ En Nehël: 44.

*“Nëse sunduesi bën ixhtihad dhe e qëllon (nuk gabon), ai ka dy shpërblime (dy sevabe). Por nëse gjykon dhe gabon (gjatë gjykimit) ai shpërblehet me një shpërblim (një sevab)”.*⁵⁷

Sahabët ixhtihadin e bërë, në kohën më të shkurtër, ia paraqitnin hollësisht Pejgamberit a.s., e nëse ixhtihadi i bërë ishte i qëlluar ai e pranonte dhe e bekonte atë kontribut dhe bënte lutje për muxhtehidin, e nëse ishte i gabuar, nuk e pranonte dhe e sqaronte shkakun e mospranimit. Në realitet ixhtihadi i sahabëve në periudhën e jetës së Pejgamberit a.s. buronte nga vetë i Dërguari i Allahut, ngase ai ose e pranonte ose e refuzonte (anulonte) atë ixhtihad. Megjithatë nga kjo periudhë sahabët përfituan një praktikë të bujshme për nxerrjen e dispozitave. Me ballafaqimin me probleme të natyrave të ndryshme, ata u ushtruan ta përdorin ixhtihadin në praninë e Pejgamberit a.s. dhe në kohën kur zbriste Kur’ani, kohë në të cilën sahabët u njoftuan me urtësitë dhe fshehtësitë e legjislacionit islam. Përcjell Abdullah b. Amri se në kohën e Pejgamberit a.s. kur dy burra kishin një mosmarrëveshje të tyre, Pejgamberin a.s., i tha Amrit: *“Gjyko midis tyre”*, Amri tha: *“Të gjykoj midis tyre e ti je i pranishëm o I dërguari i Allahut! “Po”, - iu përgjigj, nëse e qëllon ke dhjetë sevabe (shpërblime), por nëse bën ixhtihad dhe gabon ke një sevab (shpërblim)”*.

Pasi që Pejgamberi a.s. ndërroi jetë, sahabët vazhduan ixhtihadin e tyre në ngjarjet që ndodhnin, për të cilat nuk kishte argumente nga Kur’ani apo Sunneti, edhe atë duke u bazuar në Librin e Allahut xh.sh. Nëse në të e gjenin dispozitën, atëherë vepronin sipas saj dhe nuk hulumtonin më. Por në rast se pas hulumtimit nuk e gjenin hukmin e ndodhisë, atëherë i drejtoheshin Sunnetit të Pejgamberit a.s., e nëse edhe në Sunnet nuk hasnin në dispozitën e ndodhisë, atëherë hulumtonin dhe bënë ixhtihad për ta nxjerrë hukmin. Nëse në ixhtihadin e tyre gjenin pajtim të plotë në mendime, atëherë ixhtihadi (përpyekja e tyre) konsiderohej ixhma, bashkëpëlqim, i cili është burim i tretë prej burimeve të legjislacionit islam. Mirëpo shpeshherë ndodhte që të mos jenë të një mendimi dhe të kenë mendime dhe qëndrime të ndryshme mes vete për ndonjë çështje. Kundërthënia e tyre në mendime bënte që ajo çështje të mbetet në fushën e ixhtihadit, fushë kjo e cila më vonë u njoh me emrin El-Kijas القياس. Analogji, që është burimi i katërt i legjislacionit islam. Një gjë të tillë e vërteton hadithi të cilin e përcjell Muadh b. Xhebeli:

*“Kur I dërguari i Allahut dëshiroi ta dërgojë Muadhin gjykatës për në Jemen i tha: Si do të gjykojsh nëse të shtrohet ndonjë gjykim (çështje). Gjykoj me librin e Allahut, - tha Muadhi. E nëse nuk e gjen në të? (i tha i Dërguari i Allahut). Gjykoj me Sunnetin e Resulull-llahut, - u përgjigj Muadhi. Nëse nuk gjen në Sunnet e as në Kur’an? Bëj ixhtihad dhe nuk e lë mangut, - u përgjigj Muadhi”.*⁵⁸

Nga ky hadith nënkuptohet qartë se nxjerrja e dispozitave të fikhut ka filluar pas vdekjes së Pejgamberit a.s. në periudhën e sahabëve, e në anën tjetër, kuptohet se sahabët, siç ishte Abdullah b. Mes’udi, Umer b. Hattabi, Ali b. Ebu Talibi, Abdullah b. Umeri etj., nuk merrnin qëndrim me hamendje dhe pa rregull, por ata i mbështetnin qëndrimet e tyre në rregulla dhe analogji. Këtë e vërtetojnë edhe këta shembuj:

⁵⁷Muslimii.

⁵⁸Ebu Davudii.

- Në kohën e sahabëve u parashtrua problemi i sanksionimit të veprës penale për pirjen e alkoolit. Aliu r.a. për pirësin e alkoolit parasheh zbatimin e dënimit me kamxhikosje (goditje me shkopinj). Gjykon në këtë mënyrë duke bërë analogji القياس me sanksionin e shpifjes për prostitucion عقوبة القذف. Aliu r.a. e sqaroi mënyrën e nxjerrjes së dispozitës për sanksionimin e pirjes së alkoolit duke thënë: Pirësi i alkoolit kur pi alkool, te ai shkaktohet çrregullim psikik, e kur shkaktohet çrregullimi psikik atëherë ai është i pakontrolluar në fjalët e tij, e kur nuk mbanë kontroll sigurisht se bën shpifje (الافتراء), kurse sanksionimi i shpifësit, siç është argumentuar me Kur'an, është tetëdhjetë goditje me kamxhik. Aliu r.a. ixhtihadin e tij e ka bazuar në parimin e usulit مبدأ اصولي i cili është سد الذرائع mbyllja-pengim i metodave, duke e konsideruar pirjen si shkak dhe rrugë për shpifje, andaj çdo gjë që shpie drejt haramit ajo është haram.

- Sahabët kishin kundërthënie në mes veti dhe nuk ishin unanimesë rreth iddetit العدة (pritjes) së gruas shtatzënë, të cilës i ka vdekur burri. Abdullah b. Mes'udi ishte i mendimit se iddeti i saj mbaron me lindjen e fëmijës së saj, duke u bazuar në ajetin kur'anor:

"Ndërkaq për shtatzënat afati i pritjes së tyre është derisa të lindin".⁵⁹

Ajeti është i qartë në caktimin e mbarimit të iddetit, do të thotë: me lindjen e fëmijës, qoftë edhe atëherë kur ajo e lindë fëmijën disa ditë pas vdekjes së burrit të saj. Ajeti është i përgjithshëm, i cili përfshinë gruan shtatzënë të cilës i ka vdekur burri dhe gruan e shkurorëzuar që është shtatzënë. Ky ajet në shikim sipërfaqësor bie ndesh me ajetin kur'anor 234 në suren El-Bakare, i cili thotë:

"E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë". Sipas këtij ajeti, iddeti i gruas pas burrit të vdekur është katër muaj e dhjetë ditë, qoftë shtatzënë apo jo. Abdullah b. Mes'udi thotë: "Dëshmoj se kaptina e vogël e grave (suret Et-Talak الطلاق) ka zbritur pas kaptinës së madhe të grave (El-Bakare البقرة)". Me këtë ai kishte për qëllim se argumenti më i vonshëm derogon të mëparshmin, ose e përcakton, e kjo është një prej rregullave të Usulit الناسخ و المنسوخ العام والخاص.

Në bazë të asaj që thamë më parë, kuptohet qartë se sahabët gjatë ixhtihadit të tyre kishin një metodologji pune, edhe pse ata nuk janë deklaruar për çdo çështje.

Vazhduan punën në këtë mënyrë derisa erdhi periudha e tabi'inve التابعين. Në këtë periudhë u shtuan ngjarjet që kerkonin dispozita (hukme), andaj filloi të zgjerohet nxjerrja e dispozitave prej argumenteve kur'anore ose nga hadithi, në rastet kur nuk gjenin në to, ata përdornin ixhtihadin nëpërmes të cilit në këtë kohë filluan të dalin në shesh disa parime të reja usuliste. Në Medine, Seid b. Musejjebi سعيد بن المسيب në mungesë të argumentit prej Kur'anit, Sunnetit ose ixhmait të sahabëve, filloi ta ketë parasysh El-Masllahatu المصلحة për të dhënë dispozitën për çështjen e duhur. Në Irak Ibrahim En-nehai ابراهيم النخعي i mbështeste gjykimet e tij në analogji.

⁵⁹ Et Talak: 4.

3. Periudha e Imamëve Muxhtehidinë

Me zgjerimin e kufijve të shtetit islam, me pranimin e Islamit edhe nga popuj joarabë, që kishin gjuhë, kulturë, civilizim dhe traditë tjetër, dhe si rezultat i kësaj lindën rrethana të reja, teori, filozofi dhe probleme të natyrave të ndryshme që kërkonin sqarime dhe shpjegime të mirëfillta islame, për të cilat nuk kishte shpjegime të drejtpërdrejta nga Kur’ani dhe sunneti. Këto rrethana të reja sociale, shoqërore, politike e shkencore, i detyruan dijetarët islam që të angazhohen maksimalisht për gjetjen e përgjigjeve konform burimeve të sheriatit islam. Kjo e arritur, nuk mund të bëhej ndryshe për pa angazhimin maksimal të ixhtihadit. Kjo nuk nënkupton se dijetarët Islam në këtë kohë kishin shpikur ndonjë risi apo burim të sheriatit islam, ngase ixhtihadi i përdorur përmes analogjisë ka bazë Kur’anin. Sunnetin dhe praktikën e Pejgamberit a.s. si dhe nxitjen e Pejgamberit a.s. që i bënte sahabëve për të ushtruar ixhtihadin e tyre.

Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se në kohën e sahabëve me ixhtihad mund të merreshin një numër i madh i tyre, në kohën e tabi’inëve numri i atyre që kishin mundësi ta përdorin ixhtihadin ishte më i kufizuar, ngase me të mund të merreshin vetëm dijetarët, e pikërisht për këtë arsye u hapën dyert e ixhtihadit dhe u zgjerua fushëveprimi i tij.

Në periudhën e imamëve muxhtehidinë, përveç faktit se çdo dijetar jepte kontributin e vet maksimal, për të sqaruar dipozitën e çdo risie, detyrimisht duhet pasur parasysh edhe një fakt tjetër shumë të rëndësishëm për shëndoshmërinë e zhvillimit të legjislacionit islam, e që është fakti se jo çdo kush mund të përdorë ixhtihadin për përfitim të dispozitave juridike islame. Prandaj dijetarët e mirëfilltë islam në këtë periudhë filluan të përcaktojnë, rregulla dhe disiplina shkencore dhe në këtë formë filloi edhe themelimi dhe regjistrimi i shkencave islame.

Në këtë periudhë lindën fraksione të ndryshme me karakter politik, por këto fraksione u reflektuan edhe në parimet fetare islame. Nga këto fraksione më të njohurat ishin Er-rafida الرافضة, Havarixhët الخوارج, Shiat الشيعة dhe Mutezile المعتزلة. Etj.

Ajo që është shumë me rëndësi në këtë periudhë kohore është se dijetarët e Ehli sunnetit u ndanë në dy shkolla juridike kryesore që janë:

-Shkolla e hadithit, me qendër në Mekke Mukerreme dhe Medine Munevvere, respektivisht në Hixhaz, shkollë kjo e cila kryshisht mbështetej në argumentet tekstuale. Në mesin e këtyre dijetarëve vërehej një lloj mbyllje në vetveten dhe një lloj stagnimi në zhvillimin e diturive, si rezultat e ngurrimit të përdorimit të ixhtihadit. Dijetarët e kësaj shkolle sikur nuk ishin të përgatitur në mënyrë të duhur për debat dhe perceptim, mbi çështjet e reja të cilat u shfaqeshin dhe ndodhnin në atë periudhë, nuk jepnin përgjigje të qarta rreth çështjeve të reja dhe kështu tregonin një lloj konfuziteti në përfitimin e dispozitave islame.

- Shkolla racionaliste, me qendër në Kufe dhe Basra në Irak, e cila veprimtarinë e saj e mbështete në Kur'an, sunnet, Konsensusin e sahabëve dhe mendimin e tyre por karakteristikë e kësaj shkolle ishte se dijetarët e saj ishin të denjë në përdorimin Ixhtihadit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqoheshin.

Sahabët që patën ndikim në formimin e kësaj shkolle ishin: Omeri, Aliu, Ubeje, Zejdi, Ebu Dardai, dhe Ibni Mes'udi (të gjithë këta ishin muxhtehidë dhe dijetar të mëdhenj nga sahabët.

Zinxhiri i kësaj shkolle ishte: Abdullah Ibni Mes'udi – Alkometu Ibni Kajsi - Ibrahim Nah'ijut, Hamades, Ebu Hanifes, nxënësve të tij e e deri më sot.

Mes këtyre dy shkollave zhvillohej një debat i ashpër, secila e kundërshtonte metodologjin për nxjerrjen e dispozitave të shkollës tjetër. Muxhtehidët dhe dijetarët e dy shkollave me argumente tendonin të përkrahnin dhe mbronin qëndrimet e tyre. Kështu ata ndjenë nevojën për ekzistimin e metodologjisë dhe regullave mbi të cilat do mbështeten në nxjerrjen e dispozitave. Metotën e perceptimit dhe të menduarit.

Ebu Hanifja në kohën e tij fikson metodologjinë e tij themelore për nxjerrjen e dispozitave në: Kur'an, Sunnet, fetvatë e sahabëve فتاوى الصحابة në të cilat ata janë të një mendimi, e nëse ata kanë mendime të ndryshme, ai zgjedh njërin nga mendimet e tyre dhe nuk i braktisë të gjithë. "Nuk marr për bazë mendimin e tabi'inëve, ngase ata janë burra siç jemi edhe ne", thotë Ebu Hanifja sepse vetë ai ishte nga tabi'inët, për bazë ka Kijasin dhe Istihsanin الاستحسان.

Karakteristikë e veprimtarisë së Imam Ebu Hanifes është se, çështjet e fikhut dhe çështjet e tjera të ndryshme i shtjellonte dhe i hulumtonte në formë akademike përmes metodologjisë interaktive. Në akademinë tij ku merreshin vendime për çështje juridike islame prezantonin një numër i madh ekspertësh të lëmive të ndryshme, dhe pasi shkoqitej çështja nga këndvështrime të ndryshme, regjistrohej edhe fetvaja-verdikti përfundimtar për dispozitën e një çështjeje.

Kjo na jep të kuptojmë se, medhhebi Hanefi që prej fillimit ishte formuar mbi bazën e ixhtihadit kolektiv e më pak atij individual sepse preferonte, konsultimin, analizat, nxjerrjen e argumenteve, shkoqitjen e tyre dhe në fundë dispozitën. Prandaj me plotë të drejtë mund të themi se ai kishte themeluar një akademi të vërtetë shkencore, andaj koncepti akademik i Ebu Hanifes jo vetëm që dha frytet e duhura në zhvillimin shkencor të shkencave juridike islame, por jo rrallë herë ishte edhe si model edhe për shkencat tjera shoqërore.

Përkufizimi i Istihsanit

Para se të sqarojmë metodologjinë e medhhebit hanefij në përdorimin e Istihsanit si burim të sheriatit islam, fillimisht të përkufizojmë se çka është istihsanit?.

Nocioni Istihsan në kuptimin etimologjik do të thotë: konsiderimi dhe besimi se një gjë është e bukur (e mirë) عُدُّ الشَّيْءِ وَاعْتِقَادَهُ حَسَنًا.

Kurse në kuptimin terminologjik do të thotë: *“tërheqja e muxhtehidit nga dispozita, e cila është kuptuar nga analogjia e qartë (e dukshme) (kijasul xhelij) dhe përcaktimi i tij për një dispozitë tjetër, e cila është kuptuar nga analogjia e fshehtë (kijasul hafij) për të njëjtën çështje”*.

Për istihsanin gjejmë edhe këtë përkufizim: *“Tërheqja e muxhtehidit nga dispozita e përgjithshme, dhe përcaktimi i tij në një dispozite të veçantë (përfashtuese) për shkak të ndonjë argumenti, i cili e nxitë që t’i japë përparësi dispozitës së veçantë dhe ta braktisë atë të përgjithshmen”*.

Nëse muxhtehidit i parashtrohet ndonjë rast për përcaktim të dispozitës dhe, për këtë çështje nuk ka dispozitë të përfutur nga argumentet tekstuale, atëherë muxhtehidi gjatë ixhtihadit për përfitimin e dispozitës, në këtë rast para vetes i paraqiten dy alternativa: alternativa kur muxhtehidi kupton se dispozita është e qartë dhe e dukshme, dhe alternativa tjetër, kur dispozita është e fshehtë, porse edhe ajo nënkupton dispozitë të Sheriatit. Në këtë rast, muxhtehidi gjatë ixhtihadit që e bën, sigurohet se ana e fshehtë është më me prioritet që dispozita të bazohet mbi të dhe të braktiset ana e qartë. Hulumtimi i tillë quhet istihsan.

Po ashtu, nëse dispozita është e përgjithshme *حكماً كلياً*, porse muxhtehidi posedon ndonjë argument prej të cilit kupton se duhet të përjashtohet një çështje e pjesërishtme *حكم جزئي* nga dispozita e përgjithshme dhe ajo çështje e pjesërishtme të ketë dispozitë tjetër, edhe ky lloj ixhtihadi konsiderohet istihsan.

Dallimi në mes të analogjisë, istihsanit dhe maslahatul mursele

Nga definicionet që i thamë, përfiton përshtypje se edhe istihsani është analogji në njërin anë, dhe në anën tjetër të lë përshtypje sikur është çështje që i takon Maslahatul mursel (intersit të mirë). Por, megjithatë, edhe për rreth faktit se ka elemente që istihsanin e bashkon me këto dy burime të sheriatit islam, detyrimisht ka edhe elemente që e dallon prej tyre.

- Kijasi (Analogjia) në aspektin e jurisprudencës islame përkufizohet: Krahasinin e një çështjeje, për të cilën nuk ekziston dispozitë juridike nga argumentet tekstuale, me një çështje tjetër për të cilën ekziston dispozitë nga argumentet tekstuale, por që kanë motiv të përbashkët. Në këtë rast Muxhtehidi para vetes ka një çështje që dispozita e saj është e vërtetuar me argument tekstual apo me ixhma-konsensus, e kjo çështje në terminologjinë e Usulit njihet me nocionin El Aslu, dhe në anën tjetër paraqitet ndonjë çështje tjetër për të cilën nuk ekziston argument që duhet El Fer’u. Në këtë rast, nëse të dy çështjet kanë motiv (el il-letu) të përbashkët, atëherë dispozita e çështjes së parë (aslit) transferohet edhe te çështja e dytë (fer’i), ngase elemnti që bashkon nën një dispozitë është motivi (el-letu). P.sh. ndalimin e pirjes së rakisë dhe pijeve të tjera dehëse duke i bërë ato analogji-kijas me verën, sepse të gjitha këto kanë të njëjtin motov të ndalimit i cili është dehja.

Kurse Istihsanit, siç përmendëm më parë, është kur muxhtehidi tërhiqet nga dipozit e cila është kuptuar nga analogjia e qartë (e dukshme) dhe merr një dispozitë tjetër, e cila është kuptuar nga analogjia e fshehtë, sepse një gjë e tillë sjell dobi dhe është në interes të përgjithshëm njerëzor, apo menjanon ndonjë të keqe dhe të dëmshme.

- Ndërsa Maslahatul Mursele është, “Çdo dobi (interes-e mirë), e cila është brenda qëllimeve të Ligdhënësit, por për atë (dobi) nuk ekziston atgument, i cili dëshmon se Ligdhënësi një gjë e tillë e konsideroi dobi, apo nuk e konsideroi si të tillë”, që do të thotë se muxhtehidit i paraqitet një çështje, për të cilën nuk ekziston argument tekstual (nga Kur’ani Kerim dhe Sunneti), as nga ixhmai, e as nuk mund të bëhet analogji me ndonjë çështje tjetër, siç është tubimi (koleksionimi) i Kur’ani Kerimit në periudhën e Ebu Bekrit dhe të Othmanit r.a.

Prandaj Maslahatul Mursele do të thotë, ligjësimi i një dispizite të re, edhe atë duke u bazuar në parimet e përgjithëshme të Sheriatit Islam, dobive dhe interesit të njerëzve.

Llojet e Istihsanit

Nga përkufizimi i istihsanit qartë kuptohet se istihsanit ndahet në dy lloje.

1. Dhënia përparësi analogjisë së fshehtë dhe lënia e analogjisë së qartë për shkak të ndonjë argumenti, p.sh., nëse mes shitësit dhe blerësit lind mosmarrëveshje rreth çmimit të artikullit të shitur ose të blerë, para dorëzimit të sendit të shitur, respektivisht para pranimit të këtij sendi, sikur, shitësi thotë: çmimi i tij ishte njëqind dinarë (lekë), kurse blerësi pohon se çmimi ishte nëntëdhjetë lekë, dhe asnjëri nuk kanë dëshmi materiale.

Ky rast kërkon zgjedhje, kurse zgjedhja sipas parimeve islame zgjidhet si vijon: Pala paditëse, që ngre dyshime për vlerën e çmimit, duhet të parashtroj argumentet për atë që thotë, qoftë shitësi apo blerësi), kurse pala e akuzuar, që mohon duhet të betohet. Sipas këtij parimi pala akuzuese apo pretenduese nuk duhet të betohet. Kjo gjë është e qartë në lëmin e analogjisë, mirëpo në këtë rast muxhtehidi respektivisht gjykatësi duke u mbështetur në Istihsan i detyron që të dy të betohen edhe palën akuzuese edhe atë që mohon. Vlerësohet kështu nga shkak se, në këtë rast që të dy palët edhe pretenduesi edhe mohuesi (shitësi dhe blerësi), në të njëjtën kohë janë edhe pretendues, edhe mohues. Shitësi në shikim të parë është pretendues sepse (kërkon tepricë), por në të njëjtën kohë është edhe mohues për të drejtën e blerësit, që (shitësi) t’ia dorëzojë sendin me çmimin nëntëdhjetë dinarë. Pra, shitësi është në të njëjtën kohë pretendues dhe mohues. Po ashtu, blerësi në shikim të parë është mohues, i cili mohon tepricën dhjetë dinarë, porse ky është edhe pretendues, i cili pretendon se shitësi duhet t’ia dorëzojë gjënë me çmim nëntëdhjetë dinarë. Nga kjo konkludohet se edhe njëri edhe tjetri në të njëjtën kohë janë pretendues dhe mohues dhe pikërisht për këtë duhet të betohen edhe njëri edhe tjetri.

Shembull tjetër është nëse një person ka lënë vakëf tokë pjellore, por në dokumentin e vakëfit nuk ceket e drejta për ujitje dhe rruga. Në aspektin e istihsanit kjo e drejtë (ujitja dhe

rruga) i vërtetohet tokës së lënë vakëf, edhe nëse nuk përmendet në dokument, ngase sipas istihsanit, lënia e tokës vakëf është që nga ajo të ketë dobi dhe të shfrytëzohet, e nëse nuk lejohet që ajo të ujitet apo mos të ketë rrugë (mos të hyhet), atëherë ajo nuk mund të shfrytëzohet, gjë që është në kundërshtim me lënien vakëf dhe me pariment e Sheriatit islam. Sa i përket analogjisë, nuk i vërtetohet e drejta e ujitjes dhe e rrugës, nëse nuk përmendet në dokument.

2. Përrjashtimi i ndonjë çështjeje të pjesërishtme nga dispozita e përgjithshme për shkak të ndonjë argumenti, p.sh., Pejgamberi a.s. ndaloi shitjen e sendit që nuk ekziston në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes, por lejoi kontratën e shitblerjes me parapagim بيع السلم, lejoi qiranë, kontrata këto, për të cilat gjëra për të cilën bëhet kontratë nuk ekziston në kohën kur lidhjes së kontratës. Një kontratë e tillë u lejua duke u mbështetur në istihsanin, ngase njerëzit për një kontratë të tillë janë mëse të nevojshëm dhe është traditë e njohur në mesin e njerëzve.

Garantimi i zejtarit, i cili punon për shumë njerëz ضمان الاجير المشترك, gjegjësisht dora e personit që punon me mëditje الاجير mbi gjënë që duhet ta kryejë është dorë e besueshme يد امان, që nënkupton se nëse gjatë punës së tij normale, diç shkatërron ose prish ai nuk garanton, vetëm nëse shkatërrimi bëhet për shkak të moskujdesit të tij apo e prishë me qëllim, atëherë ai garanton. Me këtë që thamë bëhet analogji çdo punëtor i cili punon me mëditje në shtëpi, fabrikë, apo administratë. Por nga ky rregull dijetarët përjashtuan personin që punon me mëditje (exhir) për të gjithë njerëzit, në të njëjtën kohë, siç janë mekaniku, autoelektrici, e të ngjashëm me këta. Zejtarët e tillë gjënë e shkatërruar e garantojnë, (istihsanen) me istihsan, sepse nëse një gjë të tillë ata nuk e garantojnë, atëherë ata nuk kujdesen për pasuritë e njerëzve, gjë që është shkas për shkatërrimin e pasurive, vetëm nëse shkatërrimi bëhet për shkaqe që janë jashtë mundësive të zejtarit dhe pa dëshirën e tij, siç është shkatërrimi për shkak të vërshimit, zjarrit, tërmetit.

Nga dy shembujt e mëparshëm kuptohet se është përjashtuar një çështje prej dispozitës së përgjithshme për shkak të ekzistimit të argumentit.⁶⁰

Argumentimi i Istihsanit

Për argumentimin e istihsanit, dijetarët islamë kanë dy medh'hebe:

1. Hanefijtë, Malikijtë dhe Hanbelijtë janë të mendimit se istihsani është argument dhe një nga burimet e shariatit islam, e këtë e argumentojnë me fjalën e Allahut xh.sh.:

"Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që Allahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit".⁶¹

Po ashtu ajetin tjetër ku All-llahu xh.sh. thotë:

⁶⁰Taftazani, Ettelvihi ala Tevdih, 2/169, Mektebe Muhammed Ali, Kajro. Halaf, Abdulvehab, Ilm Usulul Fikh, 80. Zuhajli, Muhammed, Usul Fikh Islami, 194. Ebu Zehre, Muhammed, Usul Fikh, 247.

⁶¹Ez Zumer: 18.

“Dhe përmbaniu asaj më të mirës që u është shpallur nga Zoti juaj, para se t’ju vijë dënimi befasi e ju të mos dini”.⁶²

Dy ajetet e mëparshme sqarojnë qartë se myslimani ndjek atë më të mirën (më të bukurën).

Po ashtu, për argument marrin edhe hadithin e Pejgamberit a.s. i cili thotë:

“Atë që myslimanët e shohin se është e mirë, ajo te Allahu xh.sh. është e mirë, dhe atë që e shohin (myslimanët) se është e keqe, te Allahu xh.sh. është e keqe”.⁶³

Nga ky hadith nënkuptohet se atë që myslimanët e pëlqejnë dhe e shohin se është e mirë, edhe te Allahu xh.sh. është e tillë dhe e pranueshme dhe e kundërta.

2. Shafi’ijtë janë të mendimit se istihsani nuk është argument dhe burim nga burimet e Sheriatit islam. Sipas mendimit të tyre nxjerrja e dispozitave në bazë të istihsanit është nxjerrje në bazë të epshit dhe dëfrimit, pikërisht për këtë Imam Shafi’iu përpiloi libër ku rreptësisht e lufton istihsanin, saqë thotë: “Ai që bazon dispozitat mbi istihsanin, personi i tillë ka vënë ligj të ri (përveç ligjit të Allahut xh.sh)”. Librin të cilin e shkroi Imam Shafi’iu kundër istihsanit ishte “إبطال الاستحسان”⁶⁴

Shkaku i kundërthënies mes Hanefijve dhe Shafi’ijve mbi argumentimin e istihsanit qëndron aty se, secili nga dy medh’hebet studiuan istihsanin nga këndvështrime të kundërta.

Shafi’ijtë mendimin e tyre për mohimin e istihsanit e bazuan mbi atë se istihsan do të thotë: nxjerrja e dispozitave sipas intelektit dhe pasionit të njeriut, duke mos u bazuar mbi ndonjë argument të Sheriatit. Por Hanefijtë një gjë të tillë e mohojnë rreptësisht. Në lidhje me këtë dijetari i famshëm hanefij, Bezdeviu, thotë: “Ebu Hanifja është më i ndershëm dhe më i devotshëm, që ai të thotë në fe sipas dëshirës dhe pasionit të tij. Vërtet istihsani nëse është siç e sheh njeriu në bazë të dëshirës dhe pasionit të tij dhe pa argument, istihsani i tillë është i kotë”.⁶⁵

Kurse, sipas Hanefijve, istihsan është nëse muxhtehidi nuk gjykon për ndonjë çështje, siç ka gjykuar në të tjerat të ngjashme me të, për shkak të ndonjë arsyetimi (argumenti) më të fortë, i cili e detyron muxhtehidin që ai ta ndryshojë gjykimin e tij. Shafi’ijtë nuk e mohojnë këtë mënyrë për nxjerrjen e dispozitave, mënyrë kjo të cilën e ndoqën Hanefijtë, por ata mohojnë nëse për nxjerrjen e dispozitave ndiqen intelektin dhe pasionin e njeriut, gjë që këtë edhe Hanefijtë e mohojnë rreptësisht. Pra, Shafi’ijtë nuk mohojnë nëse i jepet përparësi një analogjie mbi tjetrën, nëse për të ka ndonjë argument, shkak ose motiv që e arsyetojnë atë përparësi. Këtë që e thamë e vërteton vetë fakti se Imam Shafi’iu shumë herë e përdori istihsanin për dhënien e fetvave të tij. P.sh., ai në lidhje me sasinë e parave të cilën duhet dhënë gruas së shkurorëzuar thotë: “أستحسن أن تكون (المتعة) ثلاثين درهماً” (Estehsin) *E shoh të mirë (të udhës) se mut’at e jetë tridhjetë dirhem*”.

⁶² Ez Zumer: 55.

⁶³ Ahmedi.

⁶⁴ Imam Shafi’iu, Risale, 219.

⁶⁵ Bezdevi, Fehrul Islam Ali ibn Muhammed, Kitabul Usul Lilbezdevi 4/3.

Po ashtu, Shafi'iu në lidhje me të drejtën që e posedon fqiun për pasurinë e palujtshme nëse ajo shitet, do të thotë se fqiun ka përparësi ta blejë atë nëse dëshiron, por nëse pronari i një pasurie të palujtshme e shet duke mos e pyetur fqiun e tij, fqiun ka të drejtë që të kërkojë të drejtën e tij, por nëse ai hesht një kohë të gjatë, atëherë nuk ka të drejtë të kërkojë të drejtën nga shkak se ai në mënyrë të tërthortë është pajtuar me atë shitje. Koha në të cilën ka të drejtë fqiun të kërkojë të drejtën e vet, sipas Imam Shafi'ut, është tri ditë. Në lidhje me këtë Ai thotë: *أستحسن ثبوت الشفعة للشفيع الى ثلاثة أيام* (Estehsin) *E shoh të mirë (të arsyeshme) që e drejta e fqinjësisë t'i vërtetohet fqiut gjatë tri ditëve*.

Në fund mund të konkludohet se kundërthënia ndërmjet Shafi'ijve dhe xhumhurit rreth argumentimit të istihsanit është shprehimore e jo thelbësore, nga shkak se asnjë nga dijetarët nuk pranojnë që dispozitat të mbështeten mbi intelektin dhe pasionin e njeriut, duke mos u bazuar mbi ndonjë nga argumentet e Sheriatit, kurse istihsani, ashtu siç e përku-fizuan Hanefijtë, është i pranuar te të gjithë dijetarët e katër medh'hebeve islame.⁶⁶

Dispozita e Istihsanit dhe pozita e tij në mesin e argumenteve të Sheriatit

Përmendëm më parë se xhumhuri istihsanin e pranojnë për argument, kurse Shafi'ijtë nuk e pranojnë një gjë të tillë. Hanefijtë istihsanin për argument e radhisin në rangun e katërt (pas Kur'anit, Sunnetit dhe Ixhmait). Nëse istihsani dhe kijasi vijnë në kundërshtim, përparësi i jepet istihsanit, sepse ai është lloj kijasi të cilit i jepet përparësi mbi kijasin tjetër. Pikërisht për këtë me të madhe në librat e fikhut në Medh'hebin Hanefij përdoret shprehja: "Dispozita në aspektin e istihsanit është kështu *أن الحكم استحساناً كذا*" kurse "në aspektin e kijasit-analogjisë kështu *أو قياساً كذا*". Nga këto shprehje kuptohet se të gjithë dijetarët e Medh'hebit Hanefij janë të mendimit se istihsani ka përparësi.

Të përmendim se istihsani është argument jo i prerë *دليل الظني* në domethënien mbi dispozitat, siç është kijasi, pranohet në dispozitat e fikhut, por jo në ato të akidesë-besimit.⁶⁷

Ndarja e Istihsanit te Hanefijtë

Hanefijtë istihsanin e ndajnë në disa lloje;

1. **Istihsan me argument tekstual.** Këtë lloj të istihsanit e kemi atëherë kur muxhtehidi e braktisë dispozitën e vërtetuar me kijas dhe e merr dispozitën e kundërt, e cila është vërtetuar me argument të shkruar (Kur'an apo Sunnet), siç është testamenti (vasijeti). Testamenti në Islam është i preferuar (mustehab), por kijasi një gjë të tillë e ndalon, sepse testament do të thotë: transferim i pasurisë prej pronarit të saj te personi tjetër, por pas

⁶⁶ Zuhajli, Vehbe, Usulul Fikh, 2/750. Buga, Mustafa, Etherul Edileti Muhtelefi fiha, 123. Buti, Muhammed Said, Davabitul Maslaha, 236.

⁶⁷ Zuhajli, Muhammed, Usulul Fikh, 197.

vdekjes së testamentlënës. Me vdekjen e çdo personi i cili lë testament humb të drejtën e pronësimit mbi pasurinë e tij, kurse pasuria transferohet te trashëguesit e tij, andaj nuk i lejohet që ai të qeverisë me pasurinë e tij pas vdekjes, por testamenti është preferuar për shkak të nevojës së njerëzve dhe një gjë të tillë vetë Kur'ani e ceku, ku thotë:

“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, po ashtu siç është e drejtë. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypset kryer”.⁶⁸

Ngjashëm me testamentin është qiraja.

2. Istihsan me ixhma (konsensus). Ky lloj istihساني është atëherë kur muxhtehidi braktisë dispozitën e cila nënkuptohet nga kijasi (analogjia) dhe e merr të kundërtën, e cila është vërtetuar mes ixhmait, p.sh., Akdul **istisna** (kontrata mbi prodhimin) عقد الاستصناع. Akdul **istisna** do të thotë: nëse një person bën kontratë me ndonjë mjështër që t’ia rregullojë një gjë me çmim dhe cilësi të caktuar, duke mos caktuar kohën se kur ajo gjë do të kryhet, siç është qepja e rrobave, apo ndreqja e këpucëve etj., një kontratë e tillë nëse vështrohet në aspektin e kijasit nuk lejohet, sepse bëhet kontratë për një gjë që nuk ekziston. Por, kontrata mbi prodhimin (akdul istisna) është lejuar duke e vështuar ixhmain e myslimanëve, ngase për një kontratë të tillë njerëzit kanë nevojë dhe një marrëdhënie e tillë është e njohur në mesin e njerëzve. Pra kjo kontratë është e lejuar duke e braktisur kijasin dhe duke u bazuar në ixhmain e myslimanëve.

3. Istihsan me traditë Ky lloj istihساني është atëherë kur muxhtehidi braktis ndonjë dispozitë, e cila nënkuptohet nga kijasi dhe e merr të kundërtën, për shkak se një gjë e tillë është traditë dhe veç veprohet në mesin e njerëzve. P.sh., nëse një person pendohet se nuk do të hyjë në shtëpi (apo ndonjë vend) me ndonjë person të caktuar, shtrohet pyetja se personi i tillë a konsiderohet se është zbrapsur (nuk ka qëndruar besnik) nëse hyn në çdo vend, të cilit gjuhësisht (etimologjikisht) i thuhet shtëpi, siç është xhamia, salla etj? Por, në traditën e njerëzve (në mënyrë të rëndomtë) vendeve të tilla nuk u thuhet shtëpi, andaj në bazë të asaj se traditë e njerëzve është që kur të thuhet shtëpi kuptohen shtëpitë e rëndomta e jo xhamitë apo sallat e ndryshme, nëse personi pendohet se nuk do të hyjë me ndonjë person në shtëpi, por ai hyn në xhami, atëherë ai nuk konsiderohet se është zbrapsur nga betimi i tij, andaj nuk obligohet që të shpagojë për pendimin e bërë, sepse nuk konsiderohet se është zbrapsur.

4. Istihsan për shkak të domosdoshmërisë. Ky lloj istihساني bëhet atëherë kur ekziston domosdoshmëria, e cila e detyron muxhtehidin që ta lë kijasin dhe ta marrë dispozitën e kundërt. P.sh., gjërat që janë të rënda për agjëruesin që të mbrohet nga ato, siç janë pluhuri, tymi, mushkonjat, nuk e prishin agjërimin edhe nëse futen në fytin e agjëruesit (por me kusht që agjëruesi një gjë të tillë të mos e bëjë me qëllim), ngase nga këto gjëra është shumë vështirë që agjëruesi të mbrohet gjatë agjërimit. Kjo mosprishje vërtetohet me istihsan, edhe atë për shkak të domosdoshmërisë, sepse mbrojtja nga këto gjëra është e vështirë. Kurse sipas kijasit agjërimi është i prishur, sepse çdo gjë që futet në brenda organizmit të njeriut e

⁶⁸El Bakare: 180.

prishë agjërimin, por megjithatë për shkak të nevojës së njerëzve është braktisur kijasi dhe është marrë kjo dispozitë në bazë të istihsanit.

5. Istihsan me analogji. Istihsan me analogji konsiderohet atëherë kur muxhtehidi braktis një dispozitë që nënkuptohet nga analogjia dhe e merr një dispozitë tjetër, e cila është vërtetuar me analogji, por kjo e dyta është më e saktë, më e thukët dhe më e fortë, edhe pse një analogji e tillë është e fshehtë. P.sh., nëse mes shitësit dhe blerësit ndodh mosmarrëveshje rreth çmimit të gjësë së shitur, respektivisht të blerë, para dorëzimit të saj, në këtë rast të dy palët duhet të betohen (siç kemi sqaruar më parë).⁶⁹

⁶⁹ Buga, Mustafa, Etherul Edile Muhtel Fiha, 140. Zuhajli, Vehbe, Usulul Fikh, 2/741.

Literatura e konsultuar:

Bezdevi, Fehrul Islam Ali ibn Muhammed, Kitabul Usul Lilbezdevi 4/3.
Buga, Mustafa, Etherul Edileti Muhtelefi fiha, 123.
Buti, Muhammed Said, Davabitul Maslaha, 236.
Ebu Zehre, Muhammed, Usul Fikh, 247.
Imam Shafi'iu, Risale, 219.
Mektebe Muhammed Ali, Kajro. Halaf, Abdulvehab, Ilm Usulul Fikh, 80.
Taftazani, Ettelvihi ala Tevdih, 2/169,
Zuhajli, Vehbe, Usulul Fikh, 2/750.